Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

REGIONAL ENVIRONMENTAL CENTER

NORWEGIAN MINISTRY
OF FOREIGN AFFAIRS

AMMK
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Raporti

Kadastri i Ndotësve të Ujërave të Kosovës

Faza I

Përgatiti:
Qendra Rajonale e Mjedisit, REC- Zyra në Kosovë
Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

Autorë kryesor:

Udhëheqës
Prof. dr. Zeqir Veselaj
Dr.sc. Ilir Morina

Bashkëpunëtor:
Mr.sc. Avdulla Nishori,
Msc . Dardan Bashota
Isak Gërxhaliu
Tomor Qela
Bajram Kafexholli

Koordinatore e projektit
Ardita Zekiri

Dizajni:
Ilir Berisha & Driton Selmani

Shtypur në:
Venera 2000

Ky Publikim është pjesë e projektit "Përpilimi i Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës" i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit REC- Zyra në Kosovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Projekti është mbështetur financiarisht nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë.

Përmbajtja

Fjala e Ministrit të MMPH-së 4
Fjala e REC-ut 5
Shkurtesat 6
Mirënjohje dhe falënderime 7
Parathënie 9
Hyrje 10
Rreth projektit 12
Metodologjia e punës 13
Përmbledhje ekzekutive 16
Ndotësit e Ujrave sipas Regioneve 18
Regjioni i Prizrenit 18
Regjioni Prishtinës 23
Regjioni i Pejës 30
Regjioni i Mitrovicës 36
Regjioni i Gjilanit 41
Mostrimet 48
Përfundimet dhe rekomandimet 53
Përfundimet 53
Vështirsitë 54
Rekomandimet 54
Lista e kontakteve të Zyrtarëve komunal që kanë ndihmuar në plotësimin e Formularëve 56
Për REC-un 58

Fjala e Ministrit të MMPH-së

Të nderuar lexues,

Një prej detyrave dhe përgjegjësive më të rëndësishme të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë është edhe menaxhimi i resurseve ujore, mbrojtja dhe monitorimi i cilësisë së tyre. Për të përmbushur këtë obligim, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinorë që nga themelimi i saj, përveç forcimit institucional është angazhuar edhe në ngritjen e një kornize efikase ligjore dhe programore në përputhje me kërkesat e direktivave evropiane për ujërat por edhe me kërkesat dhe nevojat e Republikës së Kosovës.

Përderisa në përgatitjen e kornizës ligjore është shënuar një progres i çmueshëm, mbrojtja efikase e resurseve ujore ende mbetet sfidë për MMPH-në në veçanti dhe shoqërinë tonë në përgjithësi. Andaj mbrojtja e resurseve ujore është një prej objektivave kryesore të MMPH-së për të ardhmen.

Ujërat e zeza urbane, bujqësia intensive dhe aktivitetet e ndryshme industriale aktualisht janë faktorët kryesorë që po kërcënojnë kualitetin e resurseve ujore përmes rritjes së shkarkimeve të ndotësve të ndryshëm në këto ujëra. Gjate këtij viti është shënuar një progres shumë i mirë në identifikimin e ndotësve të ujërave dhe përgatitjen e Kadastrit te këtyre ndotësve, si rezultat i një punë të përbashkët të Qendrës Rajonale të Mjedisit- REC, Zyra në Kosovë, Agjencionit për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës-AMMK, Departamentit te Ujerave dhe Institutit Hidrometeorologjik te Kosovës. Me këtë rast shpreh falënderim të veçantë për Qeverinë Norvegjeze për mbështetjen e këtij projekt me rëndësi shumë të madhe për sektorin e ujërave në Kosovë.

Ne vlerësojmë se identifikimi i ndotësve potencial të ujërave dhe përgatitja e kadastrit të këtyre ndotësve është një hap shumë i rëndësishëm në zgjidhjen e problemit të ujërave të ndotura në Kosovë. Andaj orientimet tona në të ardhmen do të jenë edhe në mbështetjen dhe inkurajimin e projekteve për trajtimin e ujërave të zeza dhe monitorimin e shkarkimeve të ujërave të zeza në ujërat sipërfaqësore.

Në kuadër të angazhimeve tona për të ardhmen mbetet prioritet edhe hartimi i Planit Strategjik për Administrimin e Ujërat ku një rëndësi e veçantë do ti kushtohet administrimit të ujërave të zeza.

Bashkëpunimi i institucioneve përgjegjëse në sektorin e ujërave është një prej çështjeve që kërkon përkushtim më të madh në menaxhimin efikas të ujërave. Ne shpresojmë që në angazhimet tona për këtë çështje do të kemi përkrahjen edhe të donatorëve si dhe ndihmën e zyrave rregullatore, ndërmarrjeve publike dhe organizatave të shoqërisë civile.

Uji është përbërës themelor i mjedisit dhe i jetës sonë andaj të angazhohemi të gjithë që ta ruajmë këtë resurs për të mirën e mjedisit dhe për të mirën e gjeneratave të tashme dhe të ardhshme.

Mahir Yagcilar, Ministër i MMPH-së

Fjala e REC-ut

Shekulli 21 për ujërat globale paraqitet me dy sfida të përbashkëta: sasinë dhe cilësinë e tij. Llogaritet që deri në vitin 2025, rreth 2/3 e shteteve të botës të ballafaqohen me stresin ujor. Uji i pastër, i sigurt dhe adekuat është vital për ekzistencën e organizmave të gjallë dhe funksionimin normal të ekosistemeve, komunitetit dhe ekonomisë. Por cilësia e ujërave është rrezikuar ndjeshëm me shtimin e popullatës njerëzore, zgjerimin e aktiviteteve bujqësore dhe industriale. Çdo ditë në botë, me miliona ton të ujërave të patrajtuara të kanalizimeve urbane, bujqësore dhe industriale derdhen në ujërat tona. Çdo vit lumenjtë, liqenet, , detrat dhe oqeanet pranojnë ndotjen e mbi 6.6 miliard njerëzve në planetin tonë.

Ujërat me cilësi të dobët e rrezikojnë shëndetin e njerëzve dhe integritetin e ekosistemeve, zvogëlojnë sasinë e ujit për pije në dispozicion dhe zvogëlojnë prodhimtarinë ekonomike. Janë një numër i aktiviteteve natyrore dhe njerëzore si: bujqësia, industria, minierat, depozitimi i mbeturinave, rritja e popullatës, urbanizmi dhe ndryshimet klimatike që ndikojnë në karakteristikat biologjike, kimike dhe fizike të ujërave duke ulur ndjeshëm cilësinë e tyre.

Sfidat kryesore për cilësinë e ujërave sot mund të përmblidhen në disa fusha siç janë: kontaminuesit në ujë, nutrientët, erozioni dhe sedimentet, temperatura e ujërave, acidifikimi, kripshmëria, organizmat patogjen, metalet e rënda, kimikatet, etj.

Cilësia e ujërave ka rol qendror në funksionet që luan uji në jetën tonë. Përdorimi i ujit nga njeriu për pije, pastrim dhe rekreacion, kërkon që ai të jetë i liruar nga kontaminuesit biologjik, kimik dhe fizik. Bimët, kafshët dhe habitatet që e mbështesin biodiversitetin gjithashtu kanë nevojë për ujë të pastër.

Kosova ka në dispozicion resurse ujore të cilat megjithatë falë gjeomorfologjisë dhe relievit, shumë shpejt e lëshojnë territorin e saj dhe shkojnë në drejtim të tre detrave të ndryshëm, që është rast i rrallë për një territor kaq të vogël. Cilësia e këtyre ujërave është e dobët, pasi që nuk ka as trajtim më minimal të ujërave të zeza para shkarkimit në trupat ujorë dhe në akuiferet nëntokësor.

Dr.sc. Zeqir Veselaj
Drejtor, REC Zyra në Kosovë

Shkurtesat

AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
KT	Kripërat e tretura
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapsinor
MS	Materiet e Suspenduara
OE	Operatorët Ekonomik
REC	Qendra Rajonale e Mjedisit
SHKO	Shpenzimi Kimik i Oksigjenit
$SHBO_5$	Shpenzimi Biokimik i Oksigjenit për 5 ditë
UA	Udhëzimi Administrativ

Mirënjohje dhe falënderime

Ky Raport është rezultat i punës njëvjeçare në terren të ekspertëve me përvoja dhe profesione të ndryshme, që kanë hulumtuar terrenin për të identifikuar ndotësit kryesor të ujërave të tërë territorit të Kosovës. Pa dashur të mendojmë që me këtë projekt dhe Publikim është përmbyllur puna në Kadastrin e Ndotësve të Ujërave të Kosovës, megjithatë të gjithë ata që kanë kontribuar në implementimin e projektit dhe përpilimin e këtij Raporti e meritojnë mirënjohjen më të thellë të REC-ut dhe partnerëve tjerë.

REC-u shpreh falënderim të thellë ndaj zyrtarëve të lartë të MMPH-s: Dr. Ilir Morina, kryeshef Ekzekutiv i AMMK, që ishte edhe personi i ngarkuar nga MMPH-ja për këtë projekt, Z. Arben Çitaku, Mr. Sc. Naser Bajraktari, MSc. Muhamet Malsiu, Dr. Sylë Tahirsylaj, Sabit Restelica, Tomor Çelaj, Hazir Çadraku, Ardiana Pllana, Msc. Merita Mehmeti etj. të cilët me veprimet konkrete, sugjerimet dhe komentet e tyre ndihmuan në implementimin e suksesshëm të projektit.

REC, shpreh mirënjohje të sinqertë ndaj ekipit të ekspertëve të terrenit që me muaj të tërë shkelën pothuajse çdo skaj të Kosovës: Mr.sc. Avdulla Nishori si udhëheqës i ekipeve të terrenit, Isak Gërxhaliu, MSc. Dardan Bashota, Blerina Hoxha, Mr.sc. Vehbi Goxhuli, Ilknur Ibrahimi, dhe atyre nga MMPH-ja: Bajram Kafexholli, Përparim Gashi, Agron Shala, Zeqir Imeri, Sami Behrami etj.

Mirënjohje të thellë ju shprehim përfaqësuesve të kompanive publike të ujërave dhe zyrtarëve komunal që pa kursyer ndihmuan në grumbullimin e të dhënave të kërkuara me Formularët e UA: Jehona Mavraj, Merita Dobërqani, Riza Muqolli, Haki Bekolli, Nazif Shala, Mehdi Salihu, Adnan Bullatovci, Igor Rašić, Viktor Djokić, Hazbi Ejupi, Galip Belallari, Ramadan Tafallari, Isuf Hajdari, Hasan Dishallari, Merita Luzha-Kuraja, Miftar Shala, Qaush Berisha, Rexhep Rexhepi, Elfete Blakaj, Xhelal Shabani, Rasim Mlinaku, Beqir Mehmeti, Afrim Ademi, Ajne Ibërhysaj, Faik Tofaj, Biondina Ramaj, Esat Paçarizi, Fehmi Agushi, Ruzhdi Reshitaj, Musaj Ismajli, Ibrahim Kastrati, Skender Avdyli, Alban Sokoli, Minir Haxhimusa, Bujar Dullovi, Miloš Stojković, Raif Bajrami, Srdjan Vesić, Nadire Mici, Nebojša Kenić, Ljubiša Mijaćić

Disa terma me rëndësi në Publikim

Ndotës- në kuptimin e këtij Raport nënkupton një person ose kompani që shkakton ndotjen e mjedisit.

Ujëra të ndotura- quhen ujërat të cilat janë seriozisht të ndryshuara në cilësi pas ndikimit të njeriut me: mbetjet e lëngëta të amvisërive, objekteve komerciale, industrisë dhe bujqësisë. Këto ujëra përmbajnë një spektër të gjerë ndotësish dhe atë në koncentrime të larta.

Ndotje e ujit- nënkuptohet çdo shmangie kualitative dhe kuantitative e përbërjes dhe cilësive të tij natyrore kimike, fizike dhe biologjike, të cilat kanë pasoja të padëshirueshme për shëndetin e njeriut, ekonominë e tij dhe ekosistemin në përgjithësi.

Trajtim i ujërave të ndotura- kuptojmë procesin për të bërë ujin sa më të pranueshëm për përdorim duke larguar kontaminantët kimik, fizik dhe biologjik nga uji në mënyrë që të mundësohet ripërdorimi për nevoja të ndryshme, pa pasur ndikime negative në mjedisin natyror.

Ujëra nëntokësore- janë ujërat që gjenden në sipërfaqen e tokës në poret e saj dhe në të çarat e formacioneve litologjike.

Ujëra sipërfaqësore- janë ujërat në sipërfaqe të tokës ose në rrjedha, lumenj, liqej, ligatina, detra dhe oqeane.

Kanalizimi- përfshin produktet e lëngëta shtëpiake, komunale ose industriale që rrjedhin nëpër gypa ose kanale ose struktura të ngjashme.

Kadastri- një regjistër publik, pasqyrë ose hartë e vlerave, shtrirjes dhe pronësisë së tokës me qëllim të vënies së taksave[1]**.**

Akuifer- paraqet një shtresë nëntokësore prej shkëmbinjve ujëmbajtës ose prej materialeve tjera të pakonsoliduara si shkëmbinj, rërë, zhavorr, argjilë ose lym prej të cilave ujërat nëntokësor mund të nxirren përmes puseve dhe shpimeve.

Shkarkim nënkupton çdo lëshim të ujërave të ndotura, të trajtuara apo të patrajtuara, të ujërave të përdorur, të kanalizimeve, produkteve kimike dhe nënprodukteve, mbeturinave industriale dhe substancave, pa marrë parasysh natyrën e tyre, në ujërat sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, sipërfaqe tokësore, nën tokë apo vende të gërmuara.

1 http://www.yourdictionary.com/cadastre

Parathënie

Toka shpesh quhet Planeti i Kaltër, për arsye se 2/3 e sipërfaqes së saj janë të mbuluara nga uji. Mirëpo sasia e ujit që mund të shfrytëzohet dhe është në dispozicionit e njeriut, nuk e kalon 3% të kësaj sasie. Kur kësaj përqindje të ujërave të freskëta i hiqen edhe ujërat që nuk mund të shfrytëzohen, duke qenë shumë larg vendbanimeve, ose shumë thellë në akuifere, atëherë mungesa e ujit të pijes rritet edhe më tutje. Tashmë në aspektin global, rajonal, nacional dhe lokal për ujin nuk paraqet sfidë vetëm sasia, por edhe cilësia e tij.

Një numër i madh i proceseve natyrore dhe humane ndikojnë në karakteristikat biologjike, kimike dhe fizike të ujërave, dhe kështu ndryshojnë cilësinë e tij. Janë një numër aktivitetesh që ndikojnë në cilësinë e ujit si: bujqësia, industria, minierat, deponimi i mbeturinave, rritja e popullatës, urbanizimi dhe ndryshimet klimatike.

Bujqësia, si sektor shkakton kontaminimin me nutrientë dhe pesticide si dhe salinitetin. Pasurimi i ujërave me nutrientë (nitrate dhe fosfate) është shëndrruar në një nga problemet kryesore të cilësisë së ujit, duke kontribuar me të madhe në procesin e eutrifikimit të trupave ujor. Ndërsa përdorimi i pesticideve në masë sidomos në vitet e thata ndikon në rritjen e mbetjeve të tyre në tokë dhe kështu rrisin përmbajtjen e metaleve të rënda në tretjen tokësore përmes së cilës kontaminohet uji.. Sot llogaritet se në botë përdoren mbi 2 milion ton në vit (PAN 2009).

Aktiviteti industrial shkarkon në ujërat globale për çdo vit rreth 300-400 milion ton metale të rënda, tretës, llumra toksike dhe mbeturina të tjera (UN WWAP Water and Industry). Minierat dhe shpimet krijojnë sasi të madhe të mbeturinave dhe nënprodukteve që paraqesin sfida në shkallë të gjerë.

Mungesa e hapësirave për deponim adekuat të mbeturinave urbane njerëzore ka çuar te kontaminimi në masë i ujërave. Sot 2,5 miliard njerëz jetojnë pa sanitacion të duhur (UNICEF & WHO 2008) dhe rreth 80% e kanalizimeve të vendeve në zhvillim shkarkohen në recipient pa trajtim (UN WWAP 2009). Shtimi rapid i popullatës veç sa do t`i thelloj këto probleme, ndërsa që ndryshimet klimatike po krijojnë sfidë të re edhe për cilësinë e ujërave.

Kontaminimi i ujërave i dobëson ose shkatërron ekosistemet natyrore që e mbështesin shëndetin e njeriut, prodhimtarinë ushqimore dhe biodiversitetin. Ekosistemet e ujërave të freskëta janë më të degraduarat në planet. Shumica e ujërave të freskëta e të ndotura përfundojnë në detra dhe oqeane duke dëmtuar në radhë të parë peshkimin dhe bregdetin.

Për çdo vit, më shumë njerëz po vdesin nga uji i papastër se sa të gjitha format e dhunës (përfshirë luftën), dhe më të kërcënuarit janë fëmijët. Uji i papastër dhe joadekuat, mungesa e sanitacionit dhe higjienës shkakton afër 3.1 % të vdekjeve (apo 1.7 milion raste vdekje në vit). Rreth 90% e këtyre vdekjeve janë fëmijë nën moshën 5 vjeç (WHO 2002).

Kosova në përmasa të caktuara është e prekur nga të gjitha aspektet e mësipërme të ndotjeve, dhe kjo duhet të shërbejë si nismë që përveç sasisë në planifikimet strategjike duhet marrë për bazë edhe cilësinë, ndërsa për komunitetin që përveç kursimit të ujit, duhet pasuar kujdes që ai edhe të mos ndotet.

Hyrje

Kosova ka resurse të kufizuara ujore, qoftë ujërave sipërfaqësor qoftë atyre nëntokësor, prandaj mbrojtja dhe shfrytëzimi racional i tyre është me rëndësi jetike për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të vendit. Si rrjedhojë e pozitës gjeografike lumenjtë e Kosovës shumë pak e përshkojnë territorin e saj (Ibri, Lepenci, Lumëbardhi i Prizrenit dhe Morava e Binqës) dhe shpejt dalin jashtë territorit të saj. Pjesa më e madhe e lumenjve të Kosovës janë lumenj sezonal që varen kryesisht nga reshjet atmosferike, prandaj gjatë verës atëherë kur edhe kërkesat për ujë rriten prurjet e lumenjve janë minimale.

Në vit me lagështi mesatare nga lumenjtë e Kosovës rrjedhin 3.6 x 10^9 m^3 ujë, përkatësisht 121.2 m^3/sec, ndërsa vëllimi i përgjithshëm i akumuluar në akumulimet ekzistuese është 569.690.000 m^3, që paraqet vetëm 15,7% të sasisë së përgjithshme. Liqenet natyrore janë të paktë dhe pa ndonjë rëndësi të veçantë për furnizim me ujë, ndërsa liqejt artificial janë: Batllava, Gazivoda, Badovci, Radoniqi dhe Përlepnica.

Resurset e ujërave nëntokësor janë gjithashtu të kufizuara dhe gjenden kryesisht në pjesën perëndimore të Kosovës, ku edhe rezervat e ujërave sipërfaqësor janë më të mëdha në krahasim me pjesën lindore me rezerva të pakta dhe pjesën jug-lindore ku nevojat për ujë janë shumë të mëdha.

Bazuar në të dhënat më lartë për rezervat ujore, dendësinë e popullsisë dhe natalitetin rrjedh se resurset ujore do të jenë gjithnjë e ma të kufizuara, e kur kësaj i shtojmë edhe zhvillimin urban të pa kontrolluar gjendja do të ashpërsohet edhe më shumë në të ardhmen.

Rritja e vazhdueshme e kërkesave për ujë, ushqim dhe energji, shkarkimet e vazhdueshme të mbeturinave në lumenj dhe deponitë jo sanitare si dhe ndryshimet klimatike janë tregues të cilët obligojnë një qasje ndryshe ndaj këtij burimi të kufizuar.

Kompania Rajonale e Ujit	Nr. i komunave	% e shtrirjes së shërbimeve të ujësjellësit	% e shtrirjes së shërbimeve të kanalizimit
Prishtina	7	77	66
Hidroregjioni jugor	4	49	44
Hidrodrini	4	65	34
Mitrovica	3	55	47
Radoniqi	3	95	62
Hidromorava	3	33	36
Bifurkacioni	2	42	29
Gjithsej	**25**	**60**	**48**

Përqindja e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit që ofrojnë 7 KRU të Kosovës[2]


Rrjedhojë e këtyre shkaqeve sot në botë 2/3 e popullsisë kanë strese në furnizim me ujë. Nëse kësaj i shtohet mungesa e një strategjie kombëtare, keq menaxhimi dhe shpërdorimi i ujit si në rastin tonë atëherë çështja ashpërsohet edhe më shumë.

Me një sasi prej rreth 1600m^3/ujë/kokë banori gjatë vitit, mbrojtja, ruajtja dhe zhvillimi i resurseve ujore ka rëndësi të madhe dhe gjithashtu është sfidë mjedisore por edhe me rëndësi për shëndetin publik. Jemi dëshmitar të veprimeve dhe aktiviteteve që dëmtojnë burimet ujore

2 "Raporti :Gjendja e ujërave në Kosovë" MMPH/Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Prishtinë 2010

qoftë me dëmtimin fizik të tyre po ashtu edhe me depozitimin e mbeturinave urbane, industriale, bujqësore dhe ujërave të ndotura.

Prandaj Kadastri i Ndotësve të Ujërave është hapi më i rëndësishëm në drejtimin e duhur apo drejt një menaxhimi të integruar të këtij resursi nacional me rëndësi për një zhvillim të qëndrueshëm të vendit.



Rreth projektit

Projekti Përpilimi i Kadastrit e Ndotësve të Ujërave është pjesë e Planit të Kosovës për Veprim në Mjedis 2006-2010, të përpiluar nga MMPH-ja dhe REC-u në vitin 2006. Si pjesë e një dokumenti për implementimin praktik dhe konkret të politikave mjedisore, projekti është financuar nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ndërsa është zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit REC- Zyra në Kosovë, në bashkëpunim me MMPH-në më saktësisht Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës.
Qëllimi kryesor i projektit është krijimi i një Bazë të të Dhënave që do të ndihmoj institucionet relevante të Kosovës në menaxhimin e integruar të resurseve ujore në Kosovë. Zhvillimi i Kadastrit të Ndotësve të Ujit është pjesë integrale e Sistemit Informativ për Menaxhimin e resurseve ujore në Kosovë. Një soft-ware i veçantë është zhvilluar për futjen e të dhënave të mbledhura gjatë punës në terren, si dhe të plotësohet më tutje me të dhënat e reja në vitet në vazhdim.
Përveç këtij aktiviteti kryesor, projekti ka përfshirë edhe një numër aktivitetesh tjera si:

1. Mbajtja e Forumit të Parë për Ujërat e Kosovë, në vigjiljen e Ditës Botërore të Ujërave 2010, me pjesëmarrjen e mbi 100 pjesmarrsëve nga institucionet e nivelit qendror dhe lokal, kompanitë ujore, komuniteti i donatorëve, komuniteti akademik, shoqëria civile, biznesset etj.
2. Aktivitete të ngritjes së kapaciteteve për zyrtarët relevant të institucioneve qeveritare, kompanive ujore në fushën e kadastrimit, përdorimit të soft-ware etj.
3. Një fushatë vetëdijesimi përbërë nga një videoklip për mbrojtjen e ujërave nga ndotja me titull "***Ujëra të pastra për një jetë të shëndoshë***" në Ditën Ndërkombëtare të Ujërave 2010, buletine të ndryshme me temë ujin etj.

Objektivat specifike të projektit janë:

- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave historike dhe atyre ekzistuese për ndotësit potencial të ujit;
- Krijimi, organizimi dhe arkivimi i bazës së të dhënave;
- Shkëmbimi i informacioneve në mes palëve me interes;
- Të ndihmoj departamentin e ujërave në përgatitjen e planifikimit strategjik përmes raporteve dhe informatave për rrjetin e ardhshëm të monitorimit;
- Të kontribuoj në zvogëlimin e ndotësve të ujit qoftë ata industrial apo të amvisërisë përmes një fushate të informimit publik/ngritjes së vetëdijes publike.

Megjithatë duhet të thuhet se projekti nuk ka pasur mundësi që me fondet dhe kohën në dispozicion të kryej plotësisht Kadastrin e Ndotësve të Ujërave. Arsyet janë pjesë e këtij Raporti.

Metodologjia e punës

Projekti ka filluar në vitin 2009, me aktivitetet përgatitore të punës së ekipeve në terren. Fillimisht, pas konkursit publik nga REC-u, është përzgjedhur ekipi i ekspertëve në terren, ku janë kombinuar ekspertizat e fushave të bujqësisë, kimisë, biologjisë, teknologjisë, GIS-it etj.

Ekipi i projektit fillimisht ka përpunuar Udhëzimin Administrativ nr. 61/2005 për Kadastrën e Emisioneve të Ndotësve në Mjedis dhe me Formularët që janë pjesë e këtij UA dhe që kanë të bëjnë me ndotësit në përgjithësi e në veçanti me ndotësit e ujit. Për këtë qëllim janë mbajtur disa takime konsultative mes zyrtarëve të lartë të MMPH-së (që e kanë hartuar UA), IHMK-së (si institucion që bën monitorimin e ujërave sipërfaqësor) dhe REC-ut. Pas shqyrtimit të përbashkët nen për nen të UA, dhe disa përshtatjeve gjuhësore e teknike të Formularëve, ekipi i projektit i mbështetur nga zyrtarët e MMPH-së filloj aktivitetet për grumbullimin e të dhënave në teren fillimisht në regjionin e Prizrenit.

Hartimi i planit të aktiviteteve të ekipeve në terren ishte hapi vijues, me këtë plan ishte paraparë të fillohet me grumbullimin e të dhënave në pellgun e Drinit të Bardhë, duke filluar me regjionin e Prizrenit dhe pastaj vazhdohet me Regjionin e Pejës.

Puna në terren filloi me Pellgun e Drinit, më konkretisht në komunën e Prizrenit për të vazhduar në të gjitha komunat e këtij regjioni në bashkëpunim të ngushtë me zyrtarët e MMPH.

Kontakti i parë, para vizitës në terren bëhet me Departamentin për Mjedis respektivisht me zyrtarët për Mjedis të komunës respektive me qëllim të informimit të tyre për projektin si dhe bashkëpunimi me ata në grumbullimin e të dhënave ekzistuese për ndotësit kolektiv dhe OE apo ndotësit individual.

Parimisht janë kontaktuar zyrtarët komunal për mjedis apo departamenti për mbrojtje të mjedisit me qëllim të njoftimit të tyre lidhur me projektin dhe Formularët. Nga zyrtarët komunal janë marrë të dhënat, për ndotësit kolektiv apo individual, që kanë të bëjnë me:

a. Listën e ndotësve individual,
b. Personat dhe telefonat kontaktues, nëse i kanë,
c. Vendbanimet që kanë ujësjellës dhe kanalizim,
d. Numrin e banorëve të atij vendbanimi,
e. Kategorizimin e ndotësve sipas aktiviteteve ndotëse dhe madhësisë së tyre.

Puna ka vazhduar së bashku me zyrtaret komunal në kontaktimin e kompanive publike që merren me operimin dhe mirëmbajtjen e ujësjellësve dhe kanalizimeve nga të cilët merren të dhëna për ndotësit kolektiv.

Pas marrjes së listave për ndotësit kolektiv nga zyrtarët komunal dhe lista e OE nga MMPH-ja, vazhdohet puna me vizitimin e OE veç e veç duke grumbulluar të dhënat përkatëse sipas veprimtarisë apo aktivitetit ekonomik dhe ndikimit që kanë në mjedis respektivisht ndotje të ujit.

Duhet konstatuar se shumica e zyrtarëve komunal për mjedis nuk kishin shumë njohuri lidhur me UA për Kadastrën e Emisioneve të Ndotësve në Mjedis dhe Formularëve që dalin nga ai UA.

Pas marrjes së të dhënave, janë kontaktuar të gjithë ndotësit kolektiv mbi 50 shtëpi, të cilët kanë kanalizim të organizuar, nga ku janë marrë të dhënat e nevojshme për plotësimin e Formularëve dhe koordinatat e vend-shkarkimit me GPS në sistemin **Kosova-Ref 01**.

Informacionet kryesore që grumbullohen nga ndotësit kolektiv janë: numri banorëve të atij vendbanimi, sasia dhe burimi i ujit të pijes, vend shkarkimi respektivisht koordinatat dhe sasia shkarkimeve në recipient.

Në shumicën e rasteve mungojnë të dhënat për sasinë e ujit të përdorur dhe sasinë e shkarkime-

ve. Në këto raste, nga ekipi janë përdor metodat indirekte matematikore të për llogaritjeve, bazuar në mesataren e sasisë të ujit të shpenzuar për kokë banori në Kosovë e cila vlerësohet se është **200 l/ditë** dhe numrit të banorëve të atij vendbanimi.

Në rastet kur dihet sasia e gjithëmbarshme e ujit të shpenzuar për vendbanim, atëherë kjo sasi pjesëtohet me numrin e banorëve të atij vendbanimi apo ndotësi kolektiv sipas formulës:

$$q = Q / n_{\text{banorëve}}$$

Vlen të theksohet se në vendbanimet ku burimet e ujit janë të mjaftueshme sasitë e përdorura të ujit janë mbi **250 l/ditë** (Prizren) e në disa raste mbi **700 l/ditë/kokë banori** (Mamusha, Juniku, Istogu). Sasia e shkarkimeve të ujit të ndotur në recipient llogaritet në bazë të numrit të banorëve/amvisërive dhe faktorit të emisionit sipas shprehjes:

$$Q_{\text{ujërave të ndotura}} = N_{\text{numri i banorëve}} \times fE$$

(faktori i emisionit)

ose në bazë të sasisë së gjithëmbarshme të ujit të pijes të shpenzuar sipas formulës:

$$Q_{\text{ujërave të ndotura}} = Q_{\text{uji i pijës}} \times 0{,}6$$

(koeficient: prej ujit të shpenzuar 60% kthehet në ujëra të ndotura)

Në fillim pas shpjegimeve të nevojshme, secilit ndotës u janë dhënë Formularët e UA, dhe kohë e mjaftueshme për plotësimin e tyre. Kjo metodë e punës pati ndikim në dinamikën e realizimit të aktiviteteve të planifikuara.

Kjo metodë filloi të ndikoj negativisht në dinamikën e realizimit të aktiviteteve dhe u vendos që Formularët të plotësohen bashkërisht nga ekipi i terrenit me zyrtarët kompetent të ndotësit të njëjtën ditë. Ky ndryshim ndikoj pozitivisht në përshpejtimin e realizimit të aktiviteteve.

Klasifikimi i ndotësve

Bazuar në dispozitat e UA për Kadastrin e Emisioneve të Ndotësve në Mjedis fillimisht bëhet kategorizimi i ndotësve në ndotës kolektiv dhe individual.

Ndotësit kolektiv- të cilët synohen nga projekti janë të gjithë ata ndotës kolektiv apo vendbanime që kanë mbi 50 shtëpi dhe kanë kanalizim të organizuar apo gropa septike të përbashkëta.

Ndotësit individual- apo OE që synohen nga projekti janë kryesisht ata operatorë që janë ndotës potencial më të mëdhenj si ata industrial, bujqësorë, varreza makinash/hekurishte apo pastrues kimik të mëdhenj. Në rastin e OE nuk kemi ndonjë kriter preciz, por pas shqyrtimit të listave të përgatitura nga komuna së bashku me zyrtarët e MMPH-së dhe vizitës në vend-shkarkim vendosim për OE të cilët vlerësohen se kanë ndikim më të madh në ndotjen e ujit me shkarkimet e tyre. Ndotësit e veçantë apo OE të synuar nga projekti janë:


- Shkritoret;
- Përpunuesit e hekurit;
- Hekurishtet/varrezat e makinave;
- Prodhuesit e asfaltit;
- Prodhuesit e detergjenteve dhe sapunëve;
- Prodhuesit e stiroporit dhe tekstilit;
- Pastruesit e mëdhenj kimik;
- Prodhuesit dhe përpunuesit e ushqimit dhe pijeve (lëngjet pemëve dhe ato të gazuara, konservim, rafinim dhe prodhim i vajit etj);
- Fabrikat e qumështit(qumësht dhe produkte të qumështit);
- Ferma gjedhesh dhe të shpezëve;
- Thertoret e mishit.

Një aspekt problematik i klasifikimit dhe i sigurimit të të dhënave ka qenë ajo se a janë ndotësit aktiv apo pasiv (zakonisht ndërmarrjet publike të privatizuara ose jo e që nuk punojnë).

Struktura e Formularëve

Të dhënat e grumbulluara përmes Formularëve janë të strukturuara në disa segmente:

- Kategorizimin e ndotësit (Kolektiv/Individual);
- Veprimtarinë e ndotësit;
- Vendndodhjen e ndotësit apo vend shkarkimit;
- Sasia e ujit të përdorur;
- Sasia e ujërave të ndotura që shkarkohen;
- Lloji i ujit të ndotur;
- Cilësia e ujërave të ndotur;
- Mënyra e evakuimit, dhe
- Mënyra e pastrimit.


Leposaviq
Zveçan
Mitrovicë
Zubin Potok
Mitrovicë Veriore
Podujevë
MALI I ZI
SERBIA
Vushtrri
Istog
Skenderaj
Obiliq
Prishtinë
Peje
Kline
Gllogoc
Fushë Kosovë
Kamenicë
Graqanica
Deçan
Novo Berd
Lypjan
Junik
Malisheve
Ranilluk
Shtimë
Gjilan
Gjakovë
Rahovec
Partesh
Ferizaj
Suharekë
Viti
klokot
Mamushë
Shtërpcë
Prizren
Kaçanik
Hani i Elezit
SHQIPERIA
MAQEDONIA
Dragash
Hipsometria
AMMK
0
15
30
kilometres
LEGJENDA
Kufi shtetror
Kufi komune
Lum
Shkarkim i ndotur

Përmbledhje ekzekutive

Projekti për përpilimin e Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës, ka mobilizuar një numër të madh të institucioneve nga niveli qendror dhe lokal, kompanitë ujore, ndotësit e mëdhenj si dhe ekspertë të fushave të ndryshme.

Me projektin për përpilimin e Kadastrit të Ndotësve të Ujërave të Kosovës, gjatë vitit 2009-10 janë mbuluar të 2 rajonet e pellgjeve ujore të Kosovës, janë analizuar 5 ndarjet regjionale të saj dhe 35 komuna dhe 180 vendbanime. Në Publikim, ndotësit janë paraqitur në bazë të regjioneve sipas të cilave është zhvilluar puna në terren.

Me punën në terren të ekipeve të ekspertëve, janë evidentuar 368 ndotës të ujërave. Prej tyre 266 janë ndotës kolektiv[3] ndërsa 102 janë ndotës të veçantë.

Nga pikat e regjistruara prej ekipeve të terrenit mund të konstatohet se jashtë trupave të ujërave sipërfaqësore shkarkojnë 49 ndotës prej të cilëve vetëm 5 janë ndotës kolektiv dhe 44 ndotës individual.

Në Rajonin e Pellgut të Drinit të Bardhë janë regjistruar 154 ndotës prej të cilëve 99 janë ndotës kolektiv dhe 56 janë ndotës individual. Lumenjtë, më të ngarkuar për nga numri i pikave shkarkuese ndotëse janë: Lumi i Istogut me 12, Lumbardhi i Prizrenit me 11, Drini i Bardhë me 9, Lumbardhi i Pejës me 7, Toplluha me 7, Klina me 5 ndotës, ndërsa për nga sasia prin Lumbardhi i Prizrenit. Megjithatë të gjitha këto bashkohen në Drinin e Bardhë dhe vazhdojnë në drejtim të Detit Adriatik.

Në Rajonin e Pellgut të Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës janë identifikuar 214 ndotës. Në vet Pellgun e Ibrit, janë regjistruar 100 ndotës prej të cilëve 75 janë ndotës kolektiv ndërsa 25 janë ndotës individual. Lumenjtë me numër më të madh të vendshkarkimeve të këtij pellgu janë: Sitnica me 32 pika shkarkuese, Llapi me 22, Drenica me 18, Ibri me 14, dhe Prishtevka me 7 ndotës por lumi më i ngarkuar me sasi të shkarkimeve është gjithsesi Prishtevka.

Në Pellgun e Moravës së Binçës dhe Lepencit janë 24 ndotës. Nga lumenjtë më të ngarkuar janë: Morava e Binçës me 14 pika shkarkuese dhe Lumi Mirusha me 8 pika shkarkime kolektive. Në Pellgun e Lepencit lumenjtë më të ngarkuar janë vet Lepenci dhe Miloshtica, në aspektin e numrit të banorëve që shkarkojnë.

Ndotësit individual që janë pjesë e këtij regjistri, përfshijnë që prej ndotësve të mëdhenj siç është KEK-u, Trepça etj. e deri te bizneset e vogla si ferma bujqësore, thertore, hekurishte etj. Prej këtyre ndotësve individual, 31 i derdhin ujërat e zeza në tokë respektivisht ujërat nëntokësore, ndërsa 18 të tjerë shkarkojnë në trupat ujorë të Kosovës. Në aspektin numerik, prijnë Lumbardhi i Prizrenit[4] dhe Lumi i Istogut me nga 8 ndotës, më pas vijnë Lumbardhi i Pejës dhe Llapi me nga 7, Sitnica me 5 etj. Lumi Ibër edhe pse direkt e pranon vetëm një ndotës individual, duke marrë me vete ujërat e Sitnicës dhe të Llapit bëhet recipienti kryesor i ujërave të zeza nga ndotësit individual.

Megjithatë, puna e bërë nuk ka mbuluar ndotësit më të vegjël kolektiv dhe individual, e të mos flasim për shkarkimet individuale (shtëpitë private, restoranet etj). Poashtu në disa raste nuk janë përfshirë ndotës individual potencial por që nuk janë aktiv në procesin e prodhimit (p.sh, Fabrika e Amortizatorëve) ose për shkak të procesit të privatizimit janë pa pronar konkret.

Pra puna e bërë këtyre muajve duhet të vazhdoj më tutje si fazë e dytë.

3 INë këtë listë, me pak përjashtime nuk hyjnë vendbanimet që kanë më pak se 500 banorë, ndërsa që shkarkimet individuale të shtëpive të veçanta, restorantet buzë lumenjve dhe ndotësit individual që nuk kishin aktivitet dhe as pronësi të përcaktuar.

4 Te Lumbardhi i Prizreni janë 5 restorante. Për shkak të numrit të madh të tyre dhe shpërndarjes u vendos që për këtë fazë të mos përfshihen objektet hoteliere.

Ndotësit e Ujrave sipas Regioneve

Regjioni i Prizrenit

Aktivitetet e para në terren për grumbullimin e të dhënave dhe plotësimin e Formularëve filluan me pellgun e Drinit të Bardhë, më saktësisht me komunën e Prizrenit. Fillimisht u vizitua Departamenti Komunal për Mjedis me qëllim të informimit për qëllimin dhe objektivat e projektit si dhe njohjen me Formularët që janë pjesë përbërëse e UA. Vlen të theksohet mirëkuptimi dhe bashkëpunim i plotë në realizimin e aktiviteteve si dhe ndihmën që na është ofruar nga zyrtarët për mjedis si në ofrimin e të dhënave lidhur me ndotësit gjithashtu edhe me vizitën e përbashkët tek të gjithë OE dhe vendbanimet e kësaj komune, që janë të mbuluara me kanalizim publik dhe evakuim të organizuar të ujërave të ndotura.

Në Regjionin e Prizrenit ekipi i projektit, i mbështetur nga zyrtar të MMPH-së dhe ata komunal ka evidentuar 78 ndotës prej të cilëve 56 ndotës kolektiv dhe 22 ndotës individual. Në Tabelën vijuese janë të paraqitura të dhënat për ndotësit sipas kategorive dhe komunave.

Regjioni	Komuna	Ndotësit kolektiv	Ndotësit individual
Prizren	Prizren	29	16
	Suharekë	13	2
	Rahovec	3	2
	Dragashi/Shari	6	2
	Malishevë	4	0
	Mamushë	1	0
Gjithsej		56	22

Tabela 1. Ndotësit sipas komunave dhe kategorive – Regjioni Prizren

Ndotësit kolektiv

Komuna e Prizrenit

Në këtë komunë janë identifikuar 29 ndotës kolektiv dhe 16 ndotës individual. Sa u përket ndotësve kolektiv, 13 pika shkarkuese janë vetëm në qytetin e Prizrenit, ndërsa 16 tjerë janë në fshatrat e kësaj komune që kanë kanalizim vetanak apo publik për evakuimin e ujërave të ndotura..

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Prizreni	Qyteti	185 600	Lumbardhi i Prizrenit
	Gjonaj	5 300	Drini i Bardhë
	Romajë	2 700	Përroni i Dështicës
	Korishë	7 200	Lumi i Korishës
	Hoqa e Qytetit	5 000	Buna Reka
	Zhuri	9 500	Përroi i Dobrushës
	Prevalla	150	Në 4 gropa septike
	Lubinja e Poshtme	2 100	Lumëbardhi i Prizrenit
	Lubinja e Epërme	2 300	Lumëbardhi i Prizrenit
	Pirana	2 400	Lumi Toplluhë

Tabela 2. Ndotësit kolektive- Komuna e Prizrenit

Asnjëri ndotës kolektiv nuk ka pajisje për pastrim apo trajtim mekanik, biologjik ose kimik të ujërave të zeza. Shumica e ndotësve individual janë të lidhur në kanalizimin e qytetit me përjashtim të atyre OE që janë jashtë zonës urbane apo në afërsi të ndonjë rrjedhe të ujit.

Farmakosi i cili vlerësohet se ka potencial të madh të ndikimit në mjedis por i njëjti për momentin punon me kapacitet të reduktuar dhe jo gjatë gjithë kohës. Produktet e këtij OE janë kryesisht tableta që fitohen vetëm me presion të lëndës së parë dhe pa përdorimin e ujit ashtu që shkarkimet e këtij ndotësi janë vetëm të natyrës sanitare.

Shumica e ujërave të ndotura të komunës së Prizreni derdhen në Lumbardhin e Prizrenit. Afërsisht 150000 banorë të qytetit dhe 2 fshatrave me kanalizim i shkarkojnë ujërat e ndotura në këtë lum. Lumenjtë tjerë më të atakuar janë: Përroi i Dobrushës me 9500 banorë, Lumi i Korishës me 7200, Drini i Bardhë me 5300 banorë etj. Në qendrën më turistike të Prevallës, nuk ka kanalizim të rregulluar dhe 4 gropat septike pavarësisht numrit prej 150 banorëve rezident janë shumë më të ngarkuara me numër transit të njerëzve.

Komuna e Suharekës

Suhareka është ndër komunat e rralla ku rreth 70% e vendbanimeve kanë kanalizim publik apo evakuim të organizuar të ujërave të zeza. Nga ndotësit individual në këtë komunë vlen të përmendet Ballkani New Co i cili prodhon shirita dhe rrypa të gomës dhe lënda e parë apo mbetjet që deponohen në oborrin ekonomik janë ndotësi kryesor i ujit atmosferik.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Suhareka	Qyteti	15 000	Lumi Toplluhë
	Gjinovc	3 965	Lumi i Leshanit
	Grejkovc	4 000	Lumi i Grejkovcit
	Mushtisht	6 200	Lumi i Zi dhe i Bardhë
	Samadraxha	5 000	Lumi Toplluhë
	Savrova	1 300	Lumi i Savrovës
	Sopi	1 340	Lumi i Savrovës
	Studenqan	5 000	Lumi Toplluhë
	Nëperbisht	1 280	Lumi Toplluhë

Tabela 3. Ndotësit kolektiv- Komuna e Suharekës

Lumi më i ngarkuar me shkarkime është padyshim lumi Toplluha me rreth 94580 banorë. Më pas vije Lumi i Zi dhe i Bardhë me 6200 banorë që shkarkojnë në të, Lumi i Grejkocit dhe Leshtanit me afërsisht nga 4000 banorë.

Komuna e Malishevës, Dragashit, Rahovecit dhe Mamushës

Në komunat Malishevë dhe Rahovec duhet theksuar se nuk ka munguar bashkëpunimi por përvoja e mangët e zyrtarëve për mjedis dhe mungesa e informacioneve të nevojshme lidhur me ndotësit ndikoj në evidentimin e më pak ndotësve individual. Në këto komuna nuk kemi ndonjë OE me efekt të madh në ndotjen e ujit, mund të përmendet Venaria në Rahovec.

Komuna Mamushës ngjashëm me komunat tjera të reja, ende nuk ka zyrtarë të veçantë për mjedis por të dhënat e nevojshme për pyetësor i kemi marr pa ndonjë vështirsi nga zyrtarë tjerë të komunës. Karakteristikë e kësaj komune është sasia e madhe e ujit të pijshëm për kokë banori e cila sipas zyrtarëve kalon 800 l/banorë/ditë

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Dragash	Qyteti	3 000	Lumi i Leshtanit
	Bordesan	3 550	Lumi i Plavës
	Pllave	1 300	Lumi i Plavës
	Zgatar	1 190	Lumi i Plavës
Malisheve	Qyteti	5 000	Mirusha
	Baja	4 500	Mirusha
Mamusha	Qyteti	6 000	Toplluha
Rahoveci	Qyteti	25000	Duhllu
	Xërxë	3 300	Drini i Bardhë
	Krusha e Madhe	5 600	Drini i Bardhë

Tabela 4. Ndotësit kolektiv- Komuna e Dragashit, Malishevës dhe Mamushës

Shkarkimet e këtyre komunave të gjitha janë në lumenj dhe nuk ka shkarkime në ujëra nëntokësore. Lumenjtë më të ngarkuar me ndotje janë: lumi Duhllu me 78600 banorë të Rahovecit. Më pas vie lumi Mirusha me 9500, Drini i Bardhë me 8900 banorë, Toplluha me 6000 banorë etj.


Ndotësit individual

Fillimisht, të gjithë OE edhe zyrtarëve të komunës u janë dhënë Formularët dhe koha e nevojshme për plotësimin e të dhënave të kërkuara.


Komuna	Emri i Ndotesit	Veprimtaria	Vendshkarkimi
	Abi & Elifi	Industri ushqimore	Kanalizim të qytetit
Prizren	AK Company	Pastrim kimik	Ujëra nëntokësore
	Demi	Hekurishte	Ujëra nëntokësore
	Drini Company	Prodhues i asfaltit	Ujëra nëntokësore
	Frutti	Prodhues i lëngjeve	Lumëbardhi i Prizrenit
	Iliria	Hoteleri	Lumëbardhi i Prizrenit
	KAG	Prodhues i asfaltit	Ujëra nëntokësore
	Lindi & Gea	Industri ushqimore	Kanalizim te qytetit
	Liqeni	Hoteleri	Drini i Bardhë
	Mifabeli	Hoteleri	Drini i Bardhë
	Sharri	Hoteleri	Lumëbardhi i Prizrenit
	Villapark	Hoteleri	Lumëbardhi i Prizrenit
	Sat Styro	Prodhues styropori	Lumëbardhi i Prizrenit
	Valvis	Thertore	Kanalizim te qytetit
	Sed Tours	Gurëthyes	Lumëbardhi i Prizrenit
Dragash	Meka	Thertore	Lumi i Plavës
	Rema Text	Tekstil	Lumi i Plavës
Rahovec	M-Sillosi	Industri ushqimore	Drini i Bardhe
	Stone Castle	Verari	Duhllu
Suhareka	New Co Ballkan	Industri e gomës	Toplluhë
	Ben Af	Industri ushqimore	Toplluhë

Tabela 5. Ndotësit individual sipas komunave - Regjioni i Prizrenit

Një numër i madh i OE ujërat e zeza i shkarkojnë në lumenj, ndërsa më pak nga ta në ujëra nëntokësore. Recipienti më i madh është Lumbardhi i Prizreni me 8 ndotës individual, Toplluha dhe Lumi i Plavës me nga 2, Drini i Bardhë dhe Duhllu me nga 1 etj. Në ujëra nëntokësore ujërat i shkarkojnë 4 ndotës individual, ndërsa 4 të tjerë në kanalizimin e qytetit duke i përzier me shkarkimet e ndotësve kolektiv.



Harta me emrat e pikave shkarkuese në regjionin e Prizrenit



Harta me recipientët e ndotjes sipas lumenjve në komunën e Prizrenit

Regjioni Prishtinës

Si rrjedhojë e kushteve të vështira klimatike gjatë muajit Shkurt u vendos që të ndërpritet puna në grumbullimin e të dhënave në Pellgun e Drinit dhe të kalohet në atë të Ibrit, respektivisht në regjionin e Prishtinës deri në përmirësimin e kushteve klimatike.

Regjioni	Komuna	Ndotësit kolektiv	Ndotësit e veçantë
Prishtinë	Prishtinë	12	7
	Fushë Kosovë	12	2
	Drenas	14	1
	Podujevë	9	9
	Shtime	3	0
	Lypjan	10	4
	Kastriot	7	1
	Graçanicë	8	1
Gjithsej		75	25

Tabela 6.Ndotësit sipas kategorive dhe komunave-Regjioni Prishtinë

Në këtë regjion puna ka filluar me komunën e Prishtinës dhe Kompaninë Regjionale të Ujit (KRU) "Prishtina".

Komuna e Prishtinës

Krahasuar me komunat tjera dhe bazuar në madhësinë e saj në komunën e Prishtinës evakuimi i ujërave të zeza në vendbanimet jashtë qytetit është pak i organizuar. Janë vetëm 8 vendbanime me kanalizim publik apo kanalizim vetjak ku tre prej tyre pjesërisht.

Komuna	Vendbanimi	Nr.i banorëve	Vendshkarkimi
Prishtinë	Qyteti	430 245	Prishtevka
	Bardhosh	2 150	Lumi Llap
	Barilevë	4 200	Lumi Llap
	Besi	907	Lumi Llap
	Hajvali	6 000	Graçankë
	Prroni i njelmët	1 000	Ujëra nëntokësorë
	Prugovc-Leban	800	Lumi Llap
	Shkabaj	1 500	Sitnicë
	Trudë	540	Lumi Llap
	Vranidoll	870	Lumi Llap

Tabela 7 Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna Prishtinë

Siq po shihet nga tabela, "lumi" më i ngarkuar në Komunën e Prishtinës është padyshim Prishtevka, e cila mund të thuhet se është shëndrruar në rrjedhë lumore pikërisht nga ujërat e zeza të mbi 430,000 banorëve të kryeqytetit. Lumi i dytë i ngarkuar është Llapi me rreth 9450 banorë, Graçanka me 6000 banorë dhe Sitnica me 1500 banorë. Në ujëra nëntokësorë shkarkojnë ujërat e zeza rreth 1000 banorë.

Komunat Drenas, Podujevë dhe Shtime

Komunat Drenas, Podujevë dhe Shtime janë komuna të cilat janë kompletuar pa ndonjë vështirësi si rezultat i ofrimit të ndihmës dhe të të dhënave të nevojshme si nga zyrtarët komunal qoftë për ndotësit kolektiv ashtu edhe nga ndotësit e veçantë.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Drenasi	Qyteti	9 500	Drenica
	Arllat	3 199	Drenica
	Damaneku	847	Drenica
	Gllobari	1 628	Drenica
	Komorani 1	1 699	Drenica
	Komorani 2	1 213	Drenica
	Llapushik	3 585	Drenica
	Nekoc	3 230	Drenica
	Pokleku i ri	900	Drenica
	Pokleku i vjetër	1 265	Drenica
	Shtrubullovë	1 287	Drenicë
	Tërsteniku 1	1 958	Drenica

Tabela 8. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Drenasit

Të gjitha ujërat e kanalizimeve të qytetit dhe fshatrave të Drenasit derdhen në Lumin Drenica. Në komunën e Drenasit nga OE me efekt të madh të ndotjes duhet veçuar New Co Feronikeli, i cili shkarkon ujëra me ngarkesë termike, ujëra të procesit dhe ujëra sanitar dhe nuk ka impiant për pastrimin apo para-trajtimin e tyre. Në Podujevë nga ndotësit me potencial të ndotjes së ujit është përpunuesi i vajit dhe prodhuesi i lëngjeve "Inter-Company" i cili edhe përkundër neutralizimit që i bëhet uji që shkarkohet, është i ndotur ende.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Podujevë	Qyteti	43 000	Lumi Llap
	Letanc	2 380	Lumi Llap
	Sekiraqë 1 dhe 2	760	Lumi Llap
Shtime	Qyteti	12 000	Shtimjanja
	Davidovc	648	Shtimjanja

Tabela 9. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komunat Podujevë dhe Shtime

Ujërat e zeza të këtyre dy komunave derdhen në: Lumin Llap për Podujevën respektivisht Shtimjanen për Shtimen.

Komuna e Obiliqit

Komuna e Obiliqit është një nga komunat më të ngarkuara me ndotje në Kosovë jo vetëm të ujërave por edhe ajrit dhe tokës. Sitnica përveq ndotjes nga KEK-u është e ngarkuar edhe me ujërat e zeza të kanalizimeve të rreth 15500 banorëve. Në lumin Llap shkarkojnë ujërat e zeza rreth 6500 banorë të 4 fshatrave.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Obiliqi	Qyteti	5 500	Sitnica
	Babimoci	2 000	Lumi Llap
	Dardhishtë	1 900	Sitnica
	Milloshevë, Raskovë dhe Bakshi	4 500	Lumi Llap
	Mazgit i Epërm & Ulët	4 600	Sitnica
	Palaj	1 500	Sitnica
	Plemetin	2 000	Sitnica

Tabela 10. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna Obiliq

Komuna e Lipjanit dhe e Fushë Kosovës

Në komunën e Lipjanit dhe atë të Fushë Kosovës në fillim ka pasur vështirësi në marrjen e koordinatave, si rrjedhojë e kushteve klimatike gjegjësisht vërshimeve që na ka penguar në qasje të vend-shkarkimeve por me përmirësimin e kohës këtë punë e kemi përfunduar me sukses. Nga OE në Fushë Kosovë mund të veçohet qumështorja "Bylmeti" por jo me ndonjë efekt shumë të madh në ujë.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Fushë Kosovë	Qyteti	55 000	Sitnica
	Bardhi i madh	4 800	Drenica
	Bardhi i vogël	905	Drenica
	Grabovci	1 500	Drenica
	Lismiri	1 455	Sitnica
	Pomozetin	860	Drenica
	Miradi e Epërme	2 777	Sitnica
	Miradi e Ulët	2 900	Sitnica
	Nakaradë	1 500	Sitnica
	Sllatina e Madhe	3 700	Drenica

Tabela 11. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Fushë Kosovës

Fushë Kosova, shumicën e ujërave të saj të zeza i shkarkon në Lumin Sitnica respektivisht rreth 63862 banorë. Pjesa tjetër e ujërave të zeza, nga 11765 banorë, kryesisht të fshatrave në drejtim të Drenasit derdhet në lumin Drenica.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorve	Vend-shkarkimi
Lypjani	Qyteti	12 500	Sitnicë
	Babushi i Muhaxherve	1 350	Sazlia
	Dobrajë e madhe	2 268	Sitnica
	Gracë e vogël	4 330	Sitnica
	Llugaxhi dhe Gumnasellë	2 300	Përrocka e Gumnasellës
	Rufci i Ri dhe Ribari i vogël	1 345	Sitnica
	Rufci i vjeter	665	Sitnica

Tabela 12. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit shumicën e ujërave të zeza i derdh në lumin Sitnicë, Gumnasellë dhe Sazli. Rreth 21100 banorë, përmes kanalizimeve shkarkojnë në Sitnicë. Pjesa tjetër në Sazli (1350) dhe përroskën e Gumnasellë

krijuara ka një natyrë tjetër të vështirësive, fillimisht mungesa e zyrtarëve si dhe mungesa e dokumentacioneve si pasojë e vonesave në bartjen e tij nga komunat amë. Nga OE në këtë komunë, me potencial ndotës është miniera e Kishnicës me flotacion si dhe deponia e sterileve e cila është mbrojtur nga një projekt të realizuar nga UNDP-ja.

Komuna e Graçanicës

Graçanica, si edhe në komunat tjera të sapo

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Graçanica	Qyteti	10 000	Graçanka
	Dobratini	1 233	Përrocka e Zhegovcit
	Gushterica e Epërme	600	Janjevka
	Kishnica	500	Graçanka
	Lepija	500	Sitnica
	Radeva	200	Sitnicë
	Skullaneva	360	Sitnica
	Suhadolli	600	Sitnica

Tabela 13. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna Graçanicë

Ujërat e zeza të Graçanicës shkarkohen në 4 recipient të ndryshëm. Ngarkesën më të madhe e ka lumi Graçanka me rreth 10500 banorë, më pas vie Sitnica me rreth 1660 banorë, Përrocka e Zhegovcit me rreth 1233 dhe Janjevka me rreth 600 banorë.





Foto 2 dhe 3 Ndotje Industriale – Regjioni i Prishtinës


Ndotësit individual

Regjioni i Prishtinës, edhe në të kaluarën ka qenë regjion i ngarkuar me aktivitete industriale të ndryshme. Ky regjion përmban brenda tij ndotësin kryesor aktualisht në Kosovë që është KEK-u,e më pas edhe ndotës tjerë më të vegjël.


Komuna	Emri i ndotësit	Veprimtaria	Vendshkarkimi
Prishtinë	Autoparkingu	Autopark-hekurishte	Prishtevkë
	Erona riciklim	Hekurishte	Prishtevkë
	Idea	Industri ushqimore	Prishtevkë
	Kosova Tex	Industri tekstili	Prishtevkë
	Kualiteti	Thertore	Prishtevkë
	Trafiku Urban	Autopark- Ofiçinë	Ujëra nëntokësorë
	NTP Vjosa	Industri ushqimore	Prishtevkë
Drenas	New Co Feronikel	Industri-shkritore	Drenica
Fushë Kosovë	Bylmeti	Industri ushqimore	Sitnicë
	REC KOS SHPK	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
Graçanicë	IMK Kishnica	Industri metalurgji	Graçanka dhe Lumi i Marecit
Lypjani	AL.Dushi	Pastrim kimik	Sitnicë
	NPP Bonus	Industri ushqimore	Sitnicë
	Kosova asfalt	Prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
	Qendra korrektuese	Riedukim-risocializim	Sitnicë
Obiliq	KEK	Industri energjetike	Sitnicë
Podujevë	AL Plast	Industri plastike	Lumi Llap
	FAN SHPK	Përpunim hekuri	Lumi Llap
	NTP Gashi	Industri ushqimore	Lumi Llap
	Intercompany-Nora	Industri ushqimore	Lumi Llap
	Laberion	Industri ushqimore	Lumi Llap
	Plastika	Industri Plastike	Lumi Llap
	Rafet Konushevci	Fermë e Gjedheve	Lumi Llap
	Vehbia Comerc	Autopjesë-hekurishte	Ujëra nëntokësorë

Tabela 14. Ndotësit individual sipas komunave- Regjioni Prishtinë

Sa u përket ndotësve individual, Lumi Llap është më i ngarkuar, ku derdhen 7 ndotës kryesisht industri ushqimore, plastike dhe ferma gjedhesh. Më pas vjen Lumi Prishtevka me 6 ndotës kryesisht hekurishte dhe industri ushqimore. Lumi Sitnicë është recipient i 4 ndotësve, ku padyshim se ndotësi kryesor është KEK me të gjitha kapacitetet e tij. Edhe Lumi Graçanka dhe ai i Marecit janë të ngarkuara me ndotje nga Miniera e Kishnicës, edhe pse janë bëre disa investime në ndalimin e kullimeve nga minierat dhe deponia e saj. Janë 4 ndotës individual që ujërat e zeza nuk i derdhin në lum por në tokë, prej nga ato depërtojnë në ujërat nëntokësore.



Harta me emrat e pikave shkarkuese në regjionin e Prishtinës



Harta me recipientët e ndotjes sipas lumenjve në regjionin e Prishtinës

Regjioni i Pejës

Me përmirësimin e kushteve klimatike ekipet e projektit vazhduan punën në Pellgun e Drinit respektivisht në regjionin e Pejës përkatësisht në komunën e Pejës.

Për dallim nga regjionet tjera në regjionin e Pejës paraprakisht janë vizituar të gjitha komunat e regjionit përkatësisht zyrtarët për mjedis dhe Kompanitë publike që menaxhojnë dhe operojnë ujësjellësit dhe kanalizimet, ata i njoftuam me projektin dhe pyetësorët e pastaj u dhamë kohën e duhur për plotësimin pyetësorëve. Gjithashtu zyrtarëve komunal ua dhamë edhe listën e OE për komunat përkatëse me qëllim të identifikimit të ndotësve potencial. Kjo metodë e punës nuk ndikoj shumë në përshpejtimin e grumbullimit të të dhënave. Karakteristikë e këtij regjioni është se zyrtarët komunal për mjedis kanë fare pak njohuri për Udhëzimin Administrativ dhe pyetësorët, dhe për pasojë mungojnë të dhënat dhe ju duhet një kohë shumë më e gjatë për t`i siguruar ato.

Regjioni	Komuna	Ndotësit kolektiv	Ndotësit e veçantë
Pejë	Pejë	5	10
	Gjakovë	12	6
	Deçan	5	4
	Junik *	2	0
	Klinë	8	0
	Istog	10	14
Gjithsej		42	34

Tabela 15. Ndotësit sipas kategorive dhe komunave- Regjioni Pejë

Pra në regjionin e Pejës janë 78 ndotës prej të cilëve 42 janë kolektiv ndërsa 34 janë të veçantë. Me numrin e ndotësve prin komuna e Istogut me 24, Pastaj Gjakova me 18, Peja me 15 etj.

Ndotësit individual

Komuna e Pejës

Komuna e Pejës krahasuar me komunat tjera, ka vetëm 5 vendbanime apo fshatra që kanë kanalizim për evakuimin e ujërave të ndotura. Nga OE me potencial ndotës, është Devolli Company (qumështorja dhe prodhimi i lëngjeve).

Komuna	Vendbanimi	Numri i banorëve	Vendshkarkimi
Pejë	Qyteti	90 000	Lumbardhi i Pejës
	Llozhan	650	Binxha
	Rashiq	900	Kanali i Behocit
	Vranoc	900	Lumëbardhi i Deçanit

Tabela 16 Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Pejës

Recipienti më i madh është Lumbardhi i Pejës, i cili duke kaluar përmes qytetit, merr me vete shkarkimet e rreth 90,000 banorëve kryesisht të qytetit të Pejës. Dy rjedha tjera të vogla: Binxha dhe Kanali i Behocit marrin shkarkimet e rreth 1550 banorëve.

Komuna e Deçanit dhe Junikut

Komuna e Deçanit është e vetmja komunë që nuk ka fare kanalizim publik, dhe kjo ka vështirësuar punën në marrjen e informacioneve për madhësinë dhe numrin e ndotësve kolektiv. Ekipet e projektit së bashku me zyrtarin komunal kanë identifikuar disa gropa septike dhe vendshkarkime.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Deçani	Qyteti	8 000	Ujëra nëntokësorë
	Rastovicë	700	Ujëra nëntokësorë
Juniku	Qyteti	10 000	Lumi Erenik dhe Trava

Tabela 17. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Deçanit dhe Junikut

Karakteristikë tjetër e Komunës së Deçanit është se ujërat e zeza, qoftë ato të qytetit apo ujërat e zeza të fshatrave shkarkohen në kanalet e ujitjes dhe të njëjtat gjatë sezonit të ujitje përdoren për ujitje e pastaj shkarkohen në ndonjë rrjedhë sipërfaqësore apo përmes infiltrimit në akuifer nëntokësorë.

Juniku si komunë e porsaformuar, të gjitha ujërat e zeza të rreth 10000 banorëve i derdh në Erenik dhe Travë. Një vështirësi specifike është edhe me komunat e reja si Juniku ku ende është duke u krijuar administrata komunale dhe nuk ka zyrtarë të veçantë për mjedis, mungojnë të dhëna e nevojshme për nevojat e projektit nga se ende nuk është bërë bartja e dokumentacionit nga komuna e amë ajo e Deçanit.

Komuna e Gjakovës

Qyteti i Gjakovës është i vetmi vendbanim në Kosovë, që krahas rrjetit të kanalizimit ka edhe rrjetin e evakuimit të ujërave atmosferik, gjithashtu kompania e cila menaxhon kanalizimin është duke e bërë kadastrën e rrjetit. Në këtë komunë për momentin nuk ka ndonjë industri që do të veçohej si ndotës potencial. Zona industriale e kësaj komune është pak aktive, dhe është ndër zonat e vetme që kanë gropë septike për para-trajtim të ujit të ndotur.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Gjakova	Qyteti	91 800	Ereniku
	Brovinë	700	Ereniku
	Janosh	300	Trakaniq
	Osekpash	420	Trakaniq
	Rogovë	5 000	Drini i Bardhë
	Smolicë	900	Ereniku
	Trakaniq	420	Trakaniq

Tabela 18. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Gjakovës

Recipienti kryesor në komunën e Gjakovës është Ereniku, që pranon ujërat e rreth 91000 banorëve të qytetit dhe 2 fshatrave. Pas tij vjen Drini i Bardhë që mbledh ujërat e kanalizimeve të rreth 5000 banorëve të Rogovës, dhe Trakaniqi që mbledh ujërat e zeza të mbi 1120 banorëve të 3 fshatrave.

Komuna e Istogut

Në komunën e Istogut si rrjedhojë e zgjedhjeve komunale është dashtë një kohë më e gjatë në grumbullimin e të dhënave dhe identifikimin e ndotësve potencial. E veçanta e kësaj komune është se shpenzimi i ujit të pijshëm është i lartë mbi 700 l/banorë/ditë si rrjedhojë e burimeve të mjaftueshme. Burimet e bollshme të ujit mundësojnë edhe prodhimin e peshkut dhe hudhrat e peshqve në këtë komunë janë ndotësit më të shumtë. Burgu i Dubravës është gjithashtu një ndotës kolektiv, por e veçanta e këtij ndotësi është se ka gropë septike e cila mundëson që ujërat e ndotura të shkarkohen në akuifer tokësor me efekt të zvogëluar të ndotjes.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Istogu	Qyteti	6 200	Lumi i Istogut
	Banja e Pejës	1 530	Drini i Bardhë
	Drejë	350	Lumi i Istogut
	Gurrakoc	4 330	Lumi i Istogut
	Staradran	300	Drini i vogël
	Zallq	200	Lumi i Istogut

Tabela 19. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Istogut

Recipienti më i madh në këtë komunë është Lumi i Istogut, që merr shkarkimet e kanalizimeve të mbi 11000 banorëve të qytetit dhe 3 fshatrave. Drini i Bardhë pranon shkarkimet e rreth 1530 banorëve.

Komuna e Klinës

Edhe pse territori i saj përshkohet nga 5 lumenj të ndryshëm (që është rast i rrallë në Kosovë), Klina karakterizohet me problem kronike të furnizimit me ujë, përfshi vet qytetin.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Klina	Qyteti	10 000	Drini i Bardhë dhe Klina
	Dushi	227	Drini i Bardhë
	Gllareva	4 012	Ujëra nëntokësore
	Gremniku	1 490	Drini i Bardhë
	Qabiq	1 030	Lumi Klina

Tabela 20. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Klinës

Drini i Bardhë është recipienti më i madh, duke marrë ujërat e rreth 11717 banorëve. Ndërsa fshati Gllarevë, ujërat e zeza i shkarkon në malin e afërt, respektivisht në trupa ujor nëntokësor.





Foto 4 dhe 5 Gropa septike-Burgu i Dubravës dhe Vend shkarkim pa trajtim paraprak

Ndotësit individual

Komuna	Emri i Ndotesit	Veprimtaria	Vend-shkarkimi
Pejë	Bibita	Industri ushqimore	Lumëbardhi i Pejës
	Birra Peja	Industri ushqimore	Lumëbardhi i Pejës
	Buquku	Thertore	Lumëbardhi i Pejës
	Devolli Company	Industri ushqimore	Lumëbardhi i Pejës
	Euro Steel	Hekurishte &lëndë sek.	Lumëbardhi i Pejës
	Fab. e baterive	Industri- prodhimi i bat.	Lumëbardhi i Pejës
	Kulla	Industri-rafineri e naftës	Lumëbardhi i Pejës
	Lika Company	Industri-prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
	M.M Asfallti	Industri-prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
	Leotrimi	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
Deqan	Dervish Musliaj	Fermë e dhive	Ujëra nëntokësorë
	Jetoni AG	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Stina	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Vllazërit Neziraj	Thertore	Ujëra nëntokësorë
Gjakovë	Geberland	Industri e mishit	Ereniku
	Dielli	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	EuroUnited	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Te Ylberi	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Kamilla	Industri ushqimore	Erenik
	Ekspress 2	Pastrim Kimik	Erenik
Istog	Blerimi	Thertore	Lumi i Istogut
	Burimi Bicaj	Hurdhë e peshkut	Lumi i Istogut
	California	Hurdhë e Peshkut	Lumi i Istogut
	Delfinat FB	Hurdhë e Peshkut	Lumi i Istogut
	Getrinke- Vrella	Industri ushqimore	Lumi Vrellë
	Graniti	Indus.-prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
	Kumbimi	Hurdhë e peshkut	Lumi i Istogut
	Peshkatari	Hurdhë Peshku	Lumi i Istogut
	Reciklimi	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Te Burimi	Hurdhë Peshku	Lumi i Istogut
	Teuta MI	Thertore	Lumi Vrellë
	Teuta MI	Fermë gjedhesh	Ujëra nëntokësorë
	Trofta	Hurdhë peshku	Lumi i Istogut


Tabela 21. Ndotësit Individual sipas komunave - Regjioni i Pejës

Nga ndotësit individual shihet se shumica e të evidentuarve ujërat e zeza i shkarkojnë në tokë, respektivisht në ujëra nëntokësore. Këto përfshijnë ferma shtazësh dhe thertore, hekurishte por edhe prodhues asfalti.

Lumi më i ngarkuar është Lumi i Istogut me 8 ndotës, Lumbardhi me 7 dhe Ereniku me 3 ndotës.



Harta me emrat e pikave shkarkuese në regjionin e Pejës



Harta me recipientët e ndotjes sipas lumenjve në regjionin e Pejës

Regjioni i Mitrovicës

Me përfundimin e punës në regjionin e Pejës u vazhdua puna në regjionin e Mitrovicës duke filluar me komunën e Mitrovicës dhe zyrtarin për mjedis dhe Kompaninë Rajonale të Ujësjellësit KUR "Mitrovica" nga të cilët siguruam të dhënat për ndotësit kolektiv e pastaj edhe ndotësit e veçantë.

Regjioni	Komuna	Ndotësit kolektiv	Ndotësit e veçantë
Mitrovicë	Mitrovicë	13	6
	Vushtrri	10	3
	Skenderaj	1	0
	Leposaviq	5	0
	Zveqani	3	0
	Zubin Potok	7	0
Gjithsej		39	9

Tabela 22 Ndotësit sipas kategorive dhe komunave- Regjioni Mitrovicë

Në regjionin e Mitrovicës kemi 48 ndotës, prej të cilëve 39 janë kolektiv ndërsa 9 janë individual. Prej ndotësve individual, padyshim se duhet përmendur Trepça me gjithë kompleksin e saj.

Komuna e Mitrovicës

Nga zyrtarët e kësaj ndërmarrje u siguruan të dhëna edhe për vend-shkarkimin e ujërave të ndotur si dhe sasinë e tyre për pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës. Nga ndotësit me potencial të madh të ndotjes së ujit është kompleksi Trepça, si uji që rrjedh nga miniera e Stantërgut ashtu edhe deponitë e sterileve dhe oborri ekonomik i Industrisë Kimike. Karakteristikë e ujërave që dalin nga Trepça është aciditeti dhe prezenca e metaleve të rënda në ujë.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Mitrovicë	Qyteti	84 000	Ibër
	Tuneli i Parë	1 500	Trepça
	Trepça	1 500	Trepça
	Zhabar	5 400	Ibër
	Suhodolli	2 400	Ibër

Tabela 23. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna Mitrovicë

Recipienti kryesor i shkarkimeve të ujërave të zeza është Ibri që merr ujërat e kanalizimeve të mbi 107800 banorëve.

Komuna e Skënderajt

Në komunën e Skenderajt kemi rastin e vetëm të impiantit për pastrimin e ujërave të zeza por i njëjti ende nuk është në funksion. Në këtë komunë nuk ka fashtra me kanalizim publik apo evakuim të rregulluar të ujërave të ndotura. Vendbanimet dhe ndotësit e veçantë janë të paktë në këtë komunë, pasi nuk ka ndonjë industri të dalluar.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Skenderaj	Qyteti	10 000	Lumi Klina

Tabela 24. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna Skënderaj

Komuna e Vushtrrisë

Evakuimi i ujërave të ndotur përmes kanalizimeve është mirë i zgjedhur në komunën e Vushtrrisë. Nuk kemi numër të madh të ndotësve individual me potencial të madh ndotës, mund të përmendet Fabrika "Llamkos". Ky OE, të cilin ne e vlerësuam si ndotës potencial nuk na u mundësua nga AKP-ja ta vizitojmë dhe në kohen kur ne tentuam ta vizitojmë ishte jo në funksion.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Vushtrri	Qyteti	45 000	Sitnicë
	Dobërlluke & Smrekovnice	4 570	Sitnicë
	Grace	2 800	Lumi Llap
	Lumi i M. & Stanovci	2 700	Lumi Llap
	Pestova	1 570	Sitnicë
	Svaraqaku i U. &Nadakovci	1 880	Sitnicë
	Shtitarica	1 260	Sitnicë
	Stanovc i Eperm	1 100	Lumi Llap
	Stanovc i Ulet	2 800	Lumi Llap

Tabela 25. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Vushtrrisë

Recipienti kryesor është Sitnica, që pranon shkarkimet e rreth 54280 banorëve të qytetit dhe 6 fshatrave. Lumi Llap si recipient i dytë merr shkarkimet e rreth 9400 banorëve të 5 fshatrave.





Foto 6 dhe 7 Shkarkim Kolektiv dhe Industrial

Komuna Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviç

Për shkak të situatës në veri, puna ka qenë më specifike se në komunat tjera. Ekipi i projektit ka marrë për detyrë që të dhënat të sigurohen edhe prej atje. Për këtë arsye janë kontaktuar zyrtarët komunal, të cilët kanë qenë vërtet bashkëpunues, por për shkak të rrethanave politike dhe qeverisjes me ato komuna kanë hezituar dhe refuzuar të qesin nënshkrimin në Formularët që derivojnë nga legjislacioni i Kosovës. Mirëpo në të njëjtën kohë kanë ofruar të gjitha të dhënat e kërkuara nga Formularët, të cilat i ka plotësuar një ekspert enkas i angazhuar vetëm për këto 3 komuna (njëkohësisht zyrtar komunal nga njëra komunë).

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Zubin Potok	Qyteti	3500	Ibër
	Qabra	900	Ibër
	Gazivoda/Ujmani	700	Ibër
	Velji Breg	600	Ibër
	Uglare	650	Ibër
	Jesha	850	Ibër
	Qyteti	5500	Ibër
Leposaviq	Leshak	3200	Ibër
	Soqanica	2800	Ibër
Zveqan	Qyteti	4800	Ibër

Tabela 26. Ndotësit kolektiv- Komunat Zubin Potok, Leposaviç dhe Zveçan

Të gjitha ujërat e zeza të këtyre komunave shkarkohen në lumin Ibër, i cili më tutje vazhdon në Serbi. Por e rëndësishme është se para shkarkimit bëhet një trajtim paraprak përmes gropave septike.


Komuna	Emri i Ndotësit	Veprimtaria	Vendshkarkimi
Mitrovica	Burimi	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	Dragaj & Co	Hekurishte	Ujëra nëntokësore
	Gratis Comerce	Hekurishte	Ujëra nëntokësore
	Metalurgu	Hekurishte	Ujëra nëntokësore
	Naki	Hekurishte	Ujëra nëntokësore
	Trepça	Industri metalurgjike	Ibër
Vushtrri	EMN	Industri Kimike	Lumi Tërrstena
	Eco Color	Industri Kimike	Sitnicë
	Apetit	Thertore	Sitnicë

Tabela 27. Ndotësit individual sipas komunave-Regjioni Mitrovicë

Sa u përket ndotësve individual, disa biznese hekurishtesh të vogla ujprat e zeza i derdhin në tokë. Kompleksi Trepça padyshim se e ngarkon më së tepërmi me ndotje lumin Ibër. Në lumin Sitnicë derdhen industri kimike dhe ushqimore.



Harta me emrat e pikave shkarkuese në regjionin e Mitrovicës



Harta me recipientët e ndotjes sipas lumenjve në regjionin e Mitrovicës

Regjioni i Gjilanit

Aktivitetet për grumbullimin e të dhënave për ndotësit e ujërave filluan pikërisht me komunën e Gjilanit ku zyrtarin komunal fillimisht e njoftuam për projektin, objektivat e tij si dhe UA me Formularët përkatës. Në tabelën vijuese janë paraqitur të dhënat sipas komunave dhe kategorive të ndotësve për regjionin e Gjilanit.

Regjioni	Komuna	Ndotës kolektiv	Ndotës të veçantë
Gjilan	Gjilan	9	4
	Ferizaj	8	6
	Kamenicë	7	0
	Viti	13	0
	Kaçanik	6	1
	Hani i Elezit	2	1
	Artanë	3	0
	Ranillug	3	0
	Kllokot	2	0
	Shtërpce	1	0
Gjithësej		54	12

Tabela 28 Numri i ndotësve sipas kategorive- Regjioni i Gjilanit

Në regjionin e Gjilanit janë evidentuar 66 ndotës, prej të cilës 54 janë kolektiv ndërsa 12 janë individual. Komunat me më shumë ndotës janë Ferizaj me 14, Gjilani e Vitia me nga 13 etj.

Komuna e Gjilanit

Për dallim të zyrtarëve të tjerë këtu zyrtari komunal posedon shumicën e të dhënave në formë të digjitalizuar lidhur me ndotësit kolektiv e kjo lehtësoj punën e ekipit të projektit. Të dhënat për vend shkarkimet e qytetit nuk i posedonin zyrtarët e Kompanisë Publike "Hidromorava" e cila operon dhe mirëmban kanalizimin e qytetit, por të njëjtat i siguruam nga inspektori për mjedis i komunës. Numri i vendbanimeve jashtë qytetit me evakuim kolektiv të ujërave të ndotura, është relativisht i vogël krahasuar me disa komuna tjera. Nga ndotësit e veçantë me efekt potencial ndotës është Fabrika e Radiatorëve në Gjilan.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Gjilan	Qyteti	76 900	Mirusha
	Llovca	400	Mirusha
	Malisheva	5 210	Mirusha
	Muhaxheret e Livoqit të Epërm	2 730	Mirusha
	Muhaxhert e Poneshit	1 380	Mirusha
	Shillova Serbe	1 000	Stanishor
	Shillova Shqiptare	740	Stanishor
	Uglar	2 200	Morava
	Velikinca	2 800	Morava

Tabela 29. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Gjilanit

Recipient kryesor është Lumi Mirusha që mbledh shkarkimet e rreth 85720 banorëve të qyteti dhe fshatrave ku kalon. Recipienti i dytë është Morava me pranimin e shkarkimeve të rreth 5000 banorëve të dy fshatrave, dhe më pas vie Stanishori që pranon shkarkimet e kanalizimeve të rreth 1740 banorëve.

Komuna Ferizaj, Kaçanik, dhe Hani i Elezit

Komunat Ferizaj, Kaçanik dhe Hani i Elezit janë përfunduar sipas planit dhe pa ndonjë vështirësi. Nga OE me efekt në mjedis respektivisht në ujë, vlen të veçohen Silkapor në Kaçanik, Fabrika e Vajit Ferizaj dhe Çimentorja në Hanin e Elezit.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Ferizaj	Qyteti	70 000	Nerodime
	Bablak	400	Matica
	Balaj	1 550	Nerodime
	Cërnille	1 350	Sazlia
	Muhovc	730	Sazlia
	Prelez i Muhaxherve	860	Matica
	Talinovci i Muhaxherve	1 380	Sazlia

Tabela 30. Ndotësit kolektiv- Komuna e Ferizajt

Recipienti kryeso është lumi Nerodime që pranon shkarkimet e 141550 banorëve. Më pas vie lumi Sazli që pranon shkarkimet e ujërave të zeza të 3460 banorëve.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Hani i Elezit	Qyteti	2 800	Lepenc
Kaçaniku	Qyteti	13 450	Nerodime
	Biqevc	1 620	Lepenc
	Dubrave	1 250	Lepenc
	Kovaqevc	1 420	Lepenc

Tabela 31. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Kaçaniku dhe Hani i Elezit

Edhe në komunën e Kaçanikut, recipienti kryesor është lumi Nerodime që pranon ujërat e rreth 13450 banorëve. Recipienti i dytë është Lepenci me pranimin e shkarkimeve të mbi 7000 banorëve të qytetit të Hanit të Elezit dhe fshtrave përreth,

Komuna e Vitisë

Vitia është ndër komunat e rralla që ka zgjidhë problemin me evakuimin e ujërave të zeza në shumicën e vendbanimet përmes kanalizimit.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Viti	Qyteti	8000	Morava
	Begunce	1400	Morava
	Budriga e Epërme	1200	Morava
	Dobresh	1500	Morava
	Gjylekar	3300	Morava
	Podgorc	400	Lumi Gërqarica
	Pozheran	7000	Morava
	Sllatina e Epërme	530	Lumi Gelbusha
	Sllatina e Ultë	1400	Morava
	Zhitia	1200	Morava

Tabela 32. Ndotësit kolektiv sipas komunave- Komuna e Vitisë

Recipienti kryesor në këtë komunë është Morava që pranon shkarkimet e rreth 25000 banorëve.

Komuna e Kamenicës

Gjithashtu komuna e Kamenicës ka mjaft mirë të mbuluar shumicën e vendbanimeve me kanalizim publik apo kanalizime vetjake të pjesëve të vendbanimeve në zonat rurale.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Kamenica	Qyteti	12 000	Krivareka
	Hodonoc	3 000	Krivareka
	Koretini	3 800	Krivareka
	Muqiverc	1 300	Krivareka
	Rogoqice	3 000	Krivareka
	Topanica	2 200	Krivareka

Tabela 33 Ndotësit kolektiv- Komuna e Kamenicës

Recipienti i vetëm i ujërave të kësaj komune është lumi Krivareka që pranon shkarkimet e mbi 25000 banorëve.

Komuna Novo Bërdë, Ranillug, Kllokot dhe Shtërpce.

Komunat Novobërdë/Artanë, Ranillug, Kllokot dhe Shtërpce janë komuna të reja dhe karakteristikë e tyre është si në rastin e Graçanicës dhe Junikut mungesa e zyrtarëve përkatës për mjedis, mungesa e të dhënave për ndotësit dhe mungesa e dokumentacioneve si pasojë e vonesave apo mos bartjes së tyre nga komunat amë.

Komuna	Vendbanimi	Nr. i banorëve	Vendshkarkimi
Kllokoti	Verbovc	900	Morava
	Mogilla	1700	Morava
Novoberda	Qyteti	480	Lumi Bostan
	Llabjan	1260	Klisura
	Koretisht & Pasjak	2000	Mirusha
Ranillug	Qyteti	1170	Morava
	Korminjan	1350	Morava
	Ropotove, Tomance, Pancelo	1400	Lumi i Ropotovës
Shtërpce	Qyteti	5000	Miloshtica

Tabela 34 Ndotësit kolektiv- Regjioni i Gjilanit

Miniera e Artanës, si ndotës ndodhet në territorin e komunës së Prishtinës, por efektet mjedisore barten përmes lumit të Marecit e pastaj në lumin Krivarekë të Kamenicës. Ujërat që shkarkohen janë ujëra acidik që dalin nga miniera dhe kanë potencial të lartë ndotës.






Foto 8 dhe 9 Shkarkim i Thertoreve dhe Kolektiv


Ndotësit individual

Komuna	Emri i Ndotësit	Veprimtaria	Vendshkarkimi
Gjilan	DPZ Meli	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	NTP Gazi	Thertore	Mirushë
	Fab. e Radiatorëve	Industri	Mirushë
	Kabi- Qumështore	Industri ushqimore	Moravë
Ferizaj	Burimi Company	Prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
	Eskavatori	Prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
	Lyboteni 1	Thertore	Nerodimka
	Metali	Hekurishte	Ujëra nëntokësorë
	New Co IMK	Industri metalike	Nerodimka
	Strassen&Tiefbau	Prodhues asfalti	Ujëra nëntokësorë
Hani i Elezit	Sharr Cem	Industri-çimento	Lepenc
Kaçanik	Silcapor	Industri ndërtimi	Nerodimka

Tabela 35 Ndotësit individual sipas veprimtarisë- Regjioni i Gjilanit



Harta me emrat e pikave shkarkuese në regjionin e Gjilanit



Harta me recipientët e ndotjes sipas lumenjve në regjionin e Gjilanit


Lumi	Ndotës kolektiv	Ndotës individual	Total
Lumbardhi i Prizrenit	3	5	8
Drini i Bardhë	8	3	11
Toplluha	6	2	8
Plava	3	2	5
Mirusha	2	0	2
Prishtevka	1	6	7
Llapi	15	7	22
Gracanka	3	1	4
Drenica	17	1	18
Shtimjanja	2	0	2
Sitnica	24	7	31
Lumbardhi i Pejës	1	7	8
Lumbardhi i Decanit	1	0	1
Ereniku	4	3	7
Trakaniqi	3	0	3
Istogu	4	8	12
Klina	3	0	3
Ibër	13	1	14
Trepca	2	0	2
Mirusha e Gjilanit	6	2	8
Stanishor	2	1	3
Morava	14	1	15
Nerodime	3	3	6
Matica	2	0	2
Sazlia	4	0	4
Lepenc	4	1	5
Krivareka	6	0	6
Total	156	61	217

Tabela 36. Lumenjtë sipas numrit të ndotësve

Sipas Tabelës shihet se lumenjtë më të ngarkuar me ndotës janë: Sitnica me 31, Llapi me 22, Drenica me 18, Morava e Bincës me 15, Ibri me 14, Istogu me 12 etj.

Mostrimet

Pjesë përbërëse e informacioneve të Formularëve janë edhe të dhënat lidhur me cilësinë e ujit të shkarkuar respektivisht ujit të ndotur. Ekipi i ekspertëve të REC-ut i mbështetur nga ekspertë të MMPH-së respektivisht sektorit të laboratorit të IHMK-së, ka bërë marrjen e kampionëve të ujërave të ndotur sipas një plani të aprovuar paraprakisht, fillimisht në Komunën e Prizrenit për të vazhduar pastaj në komunat dhe regjionet tjera. Pas përfundimit të regjistrimit të ndotësve nga ekipi i ekspertëve është përgatitur një plan i veçantë për marrjen e mostrave duke u bazuar në vlerësimet se ku janë pikat më të mëdha të shkarkimeve. Pikat e mostrimit janë të paraqitura në hartën vijuese.



Harta me pikat e mostrimeve të kryera gjatë projektit



Foto 10 Marrja e kampionëve

a) Metodat e punës

Për përcaktimin e parametrave fiziko-kimik te mostrave te ujit te ndotur janë përdorur këto metoda:

- Vellimetria
- Elektrokimia
- Fotometria
- Spektrofotometria UV

Bazuar në rezultatet e analizave laboratorike të IHMK nga mostrat e marra të ujit në rrjetin publik të kanalizimeve apo nga vend-shkarkimet e ndotësve industrial në të gjitha regjionet rezulton se në shumicën e rasteve vlerat e parametrave ndotës tejkalojnë ato të lejuara sipas UA. Rezultatet e analizave laboratorike tregojnë se ndotjet më të mëdha janë në kanalizimet e qendrave të mëdha urbane si atë të Prishtinës, Prizrenit, Pejës dhe Mitrovicës.

Nga rezultatet e përpunuara të analizave kimike mund të konkludohet se ka tejkalim të vlerave të SHKO dhe $SHBO_5$ bazuar në standardet e aprovuara me UA, sidomos në vend shkarkimet e qendrave të mëdha urbane si Prizreni (Zona industriale) Prishtina, Peja, Gjakova e tjera, e që janë rezultat i ndotjes nga kanalizimet dhe nga shkarkimet industriale. Gjithashtu aktivitetet industriale pa marr parasysh kapacitetin prodhues te tyre mund të ndikojë në rritjen e SHKO, së bashku me reshjet atmosferike të cilat mund të jenë të përziera me ujërat e shkarkimeve te ujërave të ndotura, e në veçanti në rritjen e këtyre parametrave kanë ndikim autolarjet apo punëtoritë e makinave te cilat shkarkojnë materie organike.

SHKO paraqet përcaktimin e sasisë së oksigjenit të cilën e shpenzojnë disa papastërti në ujë në bazë të reduktimit të tretësirës se dikromatit në kushte specifike i cili parametër ka rëndësi në përcaktimin e cilësisë së ujerave.

Analizat laboratorike të mostrave të marra në komunat Mamushë, Klinë, Malishevë dhe Skenderaj rezultojnë se parametrat që përcaktojnë cilësinë e ujit respektivisht shkalla e ndotjes është nën vlerat maksimale të lejuara me standarde të aprovuara të UA. Por kjo nuk nënkupton se në këto vendbanime nuk ka ndotje dhe se situata mund të ndryshoj shpejt si rrjedhojë e rritjes në vazhdim të popullatës edhe në këto zona urbane.

Në disa raste si në rastin e Mamushës, shkalla e ulët e ndotjes lidhet me shpenzimin e lartë të ujit të pijes dhe humbjeve të ujit (mbi 800 l/kokë banori/ditë). Si rrjedhojë e sasive të mëdha te ujit të përdorur, shkalla e ndotjes në përgjithësi nuk është shumë alarmante, por vlerësojmë se është momenti i duhur të ndërmerren masa mbrojtëse së paku një trajtim paraprak i ujërave të ndotur para shkarkimit në trupa ujor sipërfaqësor.

Nëse i referohemi rezultateve të analizave për burimet e veçanta të ndotjes apo OE vërejmë se industritë ushqimore si rasti i "STONE CASTLE " kanë ndikim me te madh në rritjen e SHKO dhe $SHBO_5$ se industritë tjera.

Karakteristikë e industrive të rënda si KEK-u, New Co Feronikeli dhe Trepça është se vlerat e SHKO dhe $SHBO_5$ në krahasim me ato të ujërave urbane janë më ulëta. Ujërat që dalin nga minierat Trepçë dhe Artanë janë ujëra acidike me pH mjaft të ulët.

Nga analizat kimike rrjedh se vlerat e parametrave tjerë janë brenda vlerave kufizuese standarde dhe nuk kalojnë vlerat maksimale te lejuara me UA për efluentët te cilët shkarkohen në trupa ujor përmes rrjetit të kanalizimit publik apo formave tjera të evakuimit të ujërave të ndotura.

Ne tabelën vijuese janë të paraqitura vlerat e parametrave ndotës për mostrat e analizuara të ujërave të shkarkuara urbane dhe industriale.

Lloji i emisionit (shprehur në mg/L)	Prizren-Zona Industriale	Prishtinë-St. i autobusëve	Stone Castle mg/L	KEK-u	Feronikeli	Vlerat standarde Sipas UA	Standardet e BE-së
Materiet e suspenduara	448	52.5	375	47	48	300	<200
Kripërat e tretura	572	247	217	329	270	150	-
SHKO me dikromat	740	148	465	63.5	27.6	100	<500
SHBO5	35.95	17	36.9	11.4	13.1	50	<250
N-(NH3)	0.325	0.89	0.36	1.0	2.16	30	<30
N- (NO2)	0.06	0.45	0.04	0.14	0.14	10	-
N-(NO3)	0.0	0.95	0.09	5.65	2.56	120	30
P- (P2 O5)	0.764	1.09	0.25	0.64	0.14	300	10

Rezultatet laboratorike të paraqitura ne Tabelen 4 krahasuar me vlerat standarde sipas UA tregojnë se ujërat e shkarkuara urbane i tejkalojnë standardet për parametrat MS, KT dhe SHKO, ndërsa vlerat e nitrateve, nitriteve, amonjakut dhe fosfateve janë me te ulëta se vlerat standarde. Vlerat e parametrave ndotës për OE ndryshojnë varësisht nga aktiviteti i tyre dhe sasia e ujit te përdorur.

Lokacioni/ Parametrat	Materiet e suspenduara	Kriprat e tretura	SHKO me dikromat	$SHBO_5$	$N-(NH_3)$	$N-(NO_2)$	$N-(NO_3)$	$P-(p_2O_5)$
Zona industriale Prizren	▲	▲	▲	▲	▼	▼	▼	▼
Fruti- Prizren	▼	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Gypi Magjistral -Prizren	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Shkolla Pedagogjike-Prizren	◊	▲	◊	◊	▼	▼	▼	▼
Tupeci-Prizren	◊	▲	◊	◊	▼	▼	▼	▼
Samadraxha-Suharekë	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Studenqani-Suharekë	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Te Ballkani-Suharekë(Qyteti)	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
New Co Ballkani	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Gjinoci-Suharekë	▼	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Rahoveci	▼	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Stone Casle	▲	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Krusha e Madhe	▲	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Mamusha	▲	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Malisheva	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Banja e Malisheves	◊	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Te Fabrika –Dragash	▼	▼	▼	▼	◊	◊	◊	◊
Rematex –Dragash	▼	▼	▼	▼	◊	◊	◊	◊
Pllava-Dragash	▼	▼	▼	▼	◊	◊	◊	◊
Pejë –Qyteti	▼	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Devolli – Pejë	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Istog – Qyteti	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Trofta – Istog	▼	▼	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Klinë –Qyteti	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Gjakovë-Qyteti	▼	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Gerberland-Gjakovë	▼	▲	▲	▲	▼	▼	▼	▼
Rogova-Gjakovë	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Juniku	▼	▼	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Deçani	▼	▲	▲	▼	▼	▼	▼	▼
Mitrovicë	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼
Flotacioni –Tepça	▼	▲	▼	▼	▼	▼	▼	▼

Legjenda: ▲mbi VML, ▼nën VML, ◊ nuk ka rezultate

Përfundimet dhe rekomandimet

Përfundimet

Kosova ka probleme serioze si me sasinë e ujërave asht edhe me cilësinë e tyre. Situata në terren është mjaft alarmante. Nuk ka trajtim minimal të ujërave të ndotura as nga ndotësit kolektiv e as nga ata individual. Si rezultat të gjitha ujërat e zeza përfundojnë në ujërat sipërfaqësore dhe ato nëntokësore pa kurrfarë trajtimi duke e rënduar ndjeshëm cilësinë e tyre.

Të gjitha shkarkimet e ujërave të ndotura në recipient bëhet pa kurrfarë trajtimi paraprak (me përjashtim Shtëpitë Korrektuese në Dubravë dhe Lypjan, impianti i këtij të fundit për momentin nuk funksionon).

Në Skenderaj ekziston impianti për trajtimin e ujërave të ndotur por nuk funksionon. Arsyet janë nga më të ndryshmet që nga çështjet teknike të ndërtimit, probleme pronësore e deri te pamundësia e mirëmbajtjes së operimit të impiantit.

Ujërat e zeza që derdhen jashtë rrjedhave ujore, kryesisht përfundojnë në ujërat nëntokësore duke paraqitur rrezik potencial për resurset e furnizimit me ujë të rreth 40% të popullatës që furnizohet me ujë. jashtë sistemeve të ujësjellësit. Karakteristikë e emisioneve në ujëra është niveli i lartë i ndotjes organike dhe mikrobiologjike si pasojë e fekaleve urbane dhe ndotjeve industriale;

Vetëm në komunat Mamushë, Malishevë, Klinë, dhe Skenderaj vlerat e parametrave të ndotjes nuk tejkalojnë ato të lejueshmet si rrjedhojë i sasive të mëdha të ujit dhe numrit të vogël të banorëve respektivisht sasisë më të vogël të emisioneve në ujë;

Ujërat e ndotur nga industria dhe minierat janë kryesisht acidik me pH të ulët dhe përmbajtje të metaleve të rënda;

Duke pasur parasysh se shumica e këtyre ujërave përmes rrjedhave respektive derdhen në drejtim të tri shteteve pritet shfaqja e ndikimeve ndërkufitare.

Legjislacioni dhe resurset njerëzore

UA për Kadastrin e Emisioneve të Ndotësve në Mjedis, respektivisht komponenti e ujërave, mund të konstatohet se nuk është duke u implementuar në asnjë komunë. Njohuritë e zyrtarëve komunal për mjedis lidhur me UA dhe Formularët për Kadastrin e Emisioneve të Ndotësve janë shumë të kufizuara.

Mungojnë një bazë e të dhënave për Ndotësit qoftë kolektiv apo ata të veçantë/individual. Asnjë ndotës i veçantë respektivisht OE nuk ka njohuri për UA dhe obligimet që rrjedhin nga i njëjti, përfshi këtu kompanitë e ujësjellësve që në shumicën e komunave kanë përsipër menaxhimin e ujërave të zeza..

Mungojnë të dhënat për sasinë e shkarkimeve tek të gjithë ndotësit e kontaktuar, ndërsa në shumicën e rasteve edhe të dhënat për sasinë e ujit të përdorur. Cilësia e ujërave të ndotura në shumicën rasteve kalon vlerat e lejuara veçanërisht në zonat e mëdha urbane (Prishtinë, Prizren, Pejë, Mitrovicë).

Zyrtarët për mjedis kanë mundësi të kufizuara për ushtrimin e funksionit të tyre, kryekëput për shkak të tretmanit që i jepet sektorit të mjedisit në komuna kështu që mungon logjistika, mungojnë kapacitetet sidomos në GIS, mungojnë pajimet si GPS, kamera dhe kompjuter me kapacitet të duhur.

Vështirsitë

Në shumicën e komunave që i kemi vizituar gjatë këtij projekti mungojnë informacionet e nevojshme për ndotësit, kanë vështirësi me logjistikë, mungesë kapacitetesh e në disa raste ka edhe zyrtarë të ri të cilët nuk kanë të dhënat më elementare.

Në komunat e reja të krijuara sipas planit gjithëpërfshirës të Ahtisarit ende mungojnë kapacitete e nevojshme dhe bartja e përgjegjësive apo dokumentacionit të nevojshëm nga komunat amë është në proces.

Lista e operatorëve ekonomik (OE) e marrë më herët në MMPH është e mangët dhe shumë operatorë nuk ekzistojnë apo kanë ndërruar veprimtarinë, telefonat kontaktues nuk korrespondojnë me ata ekzistues. Listën e fundit të OE e kemi marrë me 10/03/2010, ka nevojë të kategorizohet sipas aktiviteteve ndotëse nga se aty janë të gjithë OE e nxjerrë nga lista e bizneseve të regjistruara. Me rastin e regjistrimit në regjistrin e OE të njëjtit, regjistrojnë zakonisht edhe veprimtari të cilat nuk i ushtrojnë fare apo mendojnë në një të ardhme t`i ushtrojnë.

Një vështirësi tjetër, është edhe komunikimi i brendshëm ndër sektorial në nivel komune dhe kjo për pasojë ka marrë kohë në grumbullimin e të dhënave për plotësimin e Formularëve.

Gjatë punës në terren ka pasur raste kur zyrtarë të ndotësve kanë hezituar të japin të dhënat e nevojshme për plotësimin e Formularëve (rasti me KUR "Hidroregjioni" Prizren) apo edhe raste kur të dhënat mungonin fare.

Kryesisht mungojnë të dhënat mbi sasinë e ujit të përdorur dhe sasinë e shkarkimeve në lumenj. Në raste të tilla është përdorë metoda indirekte të përllogaritjes duke u nisë nga mesatarja e ujit të shpenzuar për kokë banori dhe përdorimi i koeficienteve për shkarkimet qoftë ujërave sanitar apo atyre të emisioneve (kalkulimi është dhënë në seksionin e metodologjisë). Ka edhe në biznese të pa regjistruara e që janë ndotës të mëdhenj si ferma për majmëri apo kapacitete për pastrim kimik.

Rekomandimet

Qeveria e Kosovës

Qeveria e Kosovës është përgjegjëse për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve të saj. Konstatimi se në Kosovë nuk ka trajtim të ujërave të zeza duhet ta shtyjë qeverinë që shumë më seriozisht të merret me këtë problem shumëdimensional që nga jeta dhe shëndeti i qytetarit, funksionimi i ekosistemeve, implikimet në zhvillimet socio-ekonomike e deri te problemet ndërkufitare që mund të dalin në të ardhmen.

Qeveria duhet të filloj me punimin e studimeve fizibilitetit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza sidomos për qendrat e mëdha urbane. Kjo, në mënyrë që të planifikohen investimet afatmesme dhe mundësitë për marrjen e kredive për implementimin e tyre.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Është institucioni përgjegjës për hartimin e politikave dhe legjislacionit për mbrojtjen e mjedisit në përgjithësi dhe ujërave në veçanti.

Duhet të rishikohet edhe njëherë UA për Kadastrin e Emisioneve Ndotëse, sepse në këtë ekzistues ka shumë mangësi dhe gabime teknike, që vështirësojnë dukshëm implementimin e tij e sidomos tek Formularët. Kjo edhe për faktin tjetër, se tashmë ka ndërruar edhe Ligji për Mjedis i vitit 2003, mbi bazën e të cilit është nxjerrë ky UA.

Duhet filloj të zbatohet UA për Kadastrin e Emisioneve të Ndotësve në të gjitha komunat, nga të gjithë ndotësit kolektiv dhe të veçantë;

MMPH me strukturat e saj (AKMM, DU, DMM) të planifikoj aktivitetet që të vazhdohet procesi me identifikimin e ndotësve të ri, thellimin në sigurimin e të dhënave të kërkuara me Formu-

larët BKU dhe BV si dhe monitorimin e atyre tashmë janë evidentuar;

Komunat

Me procesin e decentralizimit komunat kanë përgjegjësi për shumë çështje mjedisore në territorin e tyre. Është e nevojshme të bëhet ngritja e kapaciteteve njerëzore dhe teknike të zyrtarëve komunal për mjedis dhe ndotësve kolektiv dhe të veçantë lidhur me UA dhe përgjegjësive që dalin nga ky UA.

Të shqyrtohen mundësit për ndërtimin e infrastrukturës për trajtimin paraprak të ujërave të ndotur sidomos në vendbanimet e mëdha me qëllim të uljes së shkallës së ndotjes deri në kufijtë e lejuar.

Kompanitë publike

Kompanitë publike të ujësjellësit në Kosovë zakonisht janë të ngarkuara edhe me sektorin e kanalizimeve, edhe pse me një fokus më të vogël në të. Nga ky aspekt këto kompani duhet të jenë të njohura dhe involvuar në implementimin e UA respektiv si dhe me hapat në vijim sa u përket ndotësve të ujërave në Kosovë.

Ndotësit

Të obligohen OE e në veçanti ata me potencial të lartë të ndotjes që së paku të bëjnë një trajtim (neutralizim) të ujërave para shkarkimit në recipient.

Ndotësit individual me potencial të madh ndotës kanë detyrim ligjor që të bëjnë vetmonitorimin e shkarkimeve dhe të njëjtat rezultate t`ua dorëzojnë institucioneve shtetërore përgjegjëse për monitorim (AMMK).

Të bëhet monitorimi dinamik i shkarkimeve të ndotësve si në aspektin sasior edhe atë cilësor nga ana e zyrtarëve lokal për mjedis;

Lista e kontakteve të Zyrtarëve komunal që kanë ndihmuar në plotësimin e Formularëve

Nr	Komuna	Emri dhe Mbiemri	e-mail
1	Prishtinë	Jehona Mavraj Ajshe Xhemajli Merita Dobërqani	ajshe.berveniku@gmail.com
2	Podujevë	Riza Muqolli	
3	Drenas	Haki Bekolli	hakibekolli11@hotmail.com
4	Obiliq	Nazif Shala	shala.01@hotmail.com
5	Shtime	Mehdi Salihu	mehdiu@hotmail.de
6	Fushë Kosovë	Adnan Bullatovci	adnan_266@hotmail.com
7	Graqanicë	Igor Rašić Viktor Djokić	
8	Lipjan	Hazbi Ejupi	
9	Prizren	Galip Belallari Ramadan Tafallari	galip_belallari@hotmail.com
10	Therandë	Isuf Hajdari	
11	Dragash	Hasan Dishallari	hasan_dishallari@hotmail.com
12	Pejë	Merita Kuraja Miftar Shala	merita_kuraja@yahoo.com
13	Klinë	Qaush Berisha Rexhep Rexhepi	agrobleta2004@hotmail.com rexha_61@hotmail.com
14	Istog	Elfete Blakaj	elfeteblakaj@hotmail.com
15	Mitrovicë	Xhelal Shabani	xhelal.shabani@hotmail.com
16	Vushtrri	Rasim Mlinaku	rasimmlinaku@hotmail.com
17	Skenderaj	Beqir Mehmeti	
18	Gjakovë	Afrim Ademi	afrimad@hotmail.com
19	Deçan	Ajne Iberhysaj	selavi_x@yahoo.com
20	Junik	Faik Tofaj	
21	Rahovec	Biondina Ramaj	
22	Malisheva	Esat Paçarizi	
23	Gjilan	Fehmi Agushi Ruzhdi Reshitaj	fagushi@gmail.com
24	Kamenicë	Musaj Ismajli Ibrahim Kastrati	ibrahimkastrati67@hotmail.com
25	Novobërdë	Skender Avdyli	skender_67@hotmail.com
26	Viti	Alban Sokoli	albansokoli@gmail.com
27	Ferizaj	Minir Haxhimusa	minir_haxhimusa@hotmail.com
28	Kaçanik	Bujar Dullovi	buli201@hotmail.com
29	Shtërpce	Miloš Stojković Raif Bajrami	raif_bajrami@hotmail.com
30	Kllokot	Srdjan Vesić	
31	Hani Elezit	Nadire Mici	nadi_mici@hotmail.com
32	Ranillug	Nebojša Kenić	
33	Leposavic	Ljubiša Mijačić	mljubisa@hotmail.com
34	Zubin Potok	Ljubiša Mijačić	mljubisa@hotmail.com
35	Zveqan	Ljubiša Mijačić	mljubisa@hotmail.com

Për REC-un..

Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore (REC) është organizatë ndërkombëtare e pavarur, jo-avokuese, dhe jo fitim-prurëse, me mision për te ndihmuar ne zgjedhjen e problemeve mjedisore në Evropën Qendrore dhe Lindore. REC përmbush misionin duke promovuar bashkëpunim ndërmjet organizatave jo-qeveritare, qeverive, bizneseve si dhe pjesëmarrësve tjerë kyç mjedisor, përmes përkrahjes së shkëmbimit të lirë të informatave dhe pjesëmarrjes publike në vendim-marrje për mjedis.

REC është themeluar në vitin 1990, nga Shtetet e Bashkuara te Amerikës, Komisioni Evropian dhe Hungaria. Sot, REC ligjërisht vepron bazuar në Kartën e nënshkruar nga qeveritë e 29 vendeve, Komisionit Evropian, dhe në marrëveshje ndërkombëtare me qeverinë e Hungarisë. Zyra qendrore e REC-ut është ne Szentendre të Hungarisë si dhe operon nëpërmjet zyrave shtetërore në vendet përfituese: Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovine, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Estoni, Hungari, Letoni. Lituani, IRJ e Maqedonisë. Mal të Zi, Poloni, Rumani, Serbi, Sllovaki, Slloveni dhe Turqi.

Zyra e REC-ut në Kosovë është themeluar në vitin 2000, me mision për të ndihmuar zhvillimin dhe riorganizimin e shoqërisë civile mjedisore në Kosovë, dhe të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin e politikave mjedisore në fazën e zhvillimit ekonomik që po kalon Kosova.

Ekspertiza e REC-ut është e fokusuar në: hartimin e politikave mjedisore në nivel nacional dhe lokal, edukimin mjedisor, ruajtjen e biodiversitetit, menaxhimin e ujërave, mbështetjen për shoqërinë civile, informimin dhe vetëdijësimin e publikut, pjesëmarrjen në vendim-marrjen mjedisore etj.

Partnerët kryesor të REC-ut janë: Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, qeveritë komunale, organizatat joqeveritare mjedisore ndërkombëtare e vendore, mediat etj.

Donatorët kryesor për implementimin e projekteve të REC-ut në Kosovë janë: Komisioni Evropian, Sida, Qeveria e Holandës, Qeveria e Norvegjisë, KFOS etj.

Kontaktet:
Qendra Rajonale e Mjedisit për Evropën Qendrore dhe Lindore
REC- Zyra në Kosovë
Rruga Enver Maloku, nr. 28, kati V
FP 160, 10000, Prishtinë
Tel/fax: +381 (0)38 225123
E-mail: info@kos.rec.org
http://kos.rec.org